

BANKA E SHQIPËRISË

RAPORTI
VJETOR 1996

QERSHOR 1997

1. VESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI EKONOMINE SHQIPTARE

1.1 ZHVILLIMI I EKONOMISE KOMBETARE. DEGET KRYESORE TE PRODHIMIT TE PERGJITHSHEM

Ne pergjithesi viti 1996 filloi ne kushtet e nje stabiliteti te pergjithshem makroekonomik te siguruar gjate viteve te fundit. Eshte fjala per periudhen 1993-1995, periudhe se ciles pervec frenimit te thellimit te metejshe te shperpjesetimeve te brendshme dhe te jashtme te ekonomise, i korrespondon nje seri e tere vendimesh dhe rregullimesh strukturore, frut i te cilave ishte stabiliteti i pergjithshem makroekonomik. Programi ambicioz i reformave ekonomike, transformimi i ekonomise sone ne nje ekonomi tregu nepermjet nje politike masive privatizimi te ndermarrjeve shtetore dhe te tokes, liberalizimi ne shkalle te gjere i cmimeve te konsumit, liberalizimi i tregtise se jashtme, reforma ne sistemin bankar, reforma e sistemit legjislativ ne pikepamje sasiore dhe cilesore, zgjerimi dhe permiresimi i sistemit fiskal te vendit, ristrukturimi i ndermarrjeve shtetore, hyrjet e konsiderueshme ne formen e asistences ekonomike dhe hyrjet e kapitalit nga jashte, dergesat ne te holla nga nje numer i madh shqiptarësh qe punojne jashte shtetit, vendosja strategjike e Shqiperise etj. konsiderohen si faktoret vendimtare ne arritjen e ketij stabiliteti.

Qe nga fillimi i programit stabilizues ne vitin '93 prodhimi total ka njohur rritje te fuqishme. Shqiperia perjetoj rritjen me te larte kumulative te GDP nder gjithë vendet ne tranzicion ne vijim te kolapsit ekonomik qe keto vende kaluan ne fillim te viteve '90.


* * *

Prodhimi i Pergjithshem i Brendshem (GDP), gjate vitit 1996 (me cmime konstante te vitit 1990) vleresohet te jete rritur ne masen 8.9 per qind¹. Kjo rritje e larte ekonomike ka bere qe ne fund te vitit te 1996 niveli vjetor i te ardhurave per fryme, nga rreth 700 USD ne fund te vitit 1995, te luhatet ne kufirin 850 - 900 USD.


Tabela 1.1. Prodhimi i Pergjithshem

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996
	(Ne milione leke, me cmime korrente)						
GDP	16.813		50.697	125.334	184.393	229.763	280.515
	(Ndryshimi ne %)						
GDP	-10,0	-28,0	-7,2	9,6	8,3	13,3	8,9
Prodhimi Industrial	-14,2	-42,0	-51,2	-10,0	-2,0	6,0	13,6
Prodhimi Bujqesor	-5,4	-17,4	18,5	10,4	10,3	13,2	3,0


¹ Sipas te dhenave me te fundit te Departamentit te Zhvillimit Ekonomik dhe Ndhimes se Huaj (DEDAC), GDP-ja ne vitin 1996 vleresohet ne masen 280.5 miliarde leke.



Graf. 1.1. Rritja reale e GDP-se
(ne % mbi vitin e kaluar)



Graf. 1.2. Rritja reale e Prodhimit Industrial
(ne % mbi vitin e kaluar)



Graf. 1.3. Rritja reale e Prodhimit Bujqesor
(ne % mbi vitin e kaluar)

Rritja e fuqishme ekonomike kryesisht i atribuohet sektorit privat vecanerisht ndertimit dhe sherbimeve. Sukses i ketyre dy degeve te fundit perfaqesohet nga investime te cilat jane financuar nga hyrjet e medha ne valute nga emigrantet (llogariten te jene me shume se 18 per qind e GDP-se ne vitin 1996). Nga ana tjeter rritja e madhe e prodhimit te energjise elektrike dhe industrise ushqimore jane faktoret kryesore te cilet kontribuan ne nje rritje te larte te prodhimit industrial. Duhet theksuar se gjate vitit 1996 u evidentua nje renie e dukshme ne rritjen e prodhimit bujqesor si dhe nje kontraktim i forte i sektorit te transportit.

Kjo rritje e madhe e prodhimit ishte pergjigje e fuqizimit te ndjeshem te agregatit te kerkeses se brendshme, e cila nga ana e saj ushtroi presione te fuqishme mbi cmimet e konsumit megjithe perpjekjet e bera per ta vene ate nen kontroll. Kesaj kerkese te rritur, pervec importeve ne rritje, gjithnje e me shume po i pergjigjet prodhimi i realizuar ne dege te tilla si industri, bujqesi, ndertim, sherbime etj.

Ne ndryshim nga vitet e meparshem, pas nje rritjeje prej 6 per qind ne vitin 1995, **prodhimi industrial** njohu nje tjeter rritje gjate 1996, por kete rradhe me dy shifra, rreth 14 per qind². Nisur nga fakti se vazhdon stanjacioni ne prodhimin industrial ne sektorin shteteror te ekonomise, eshte e kuptueshme qe kjo rritje i atribuohet teresisht prodhimit te energjise elektrike dhe sektorit privat te ekonomise. Privatizimi i ndermarrjeve ekzistuese, investimet e vete shqiptareve si dhe programet e ndryshme te huaja financuese kane bere qe shume investitore vendas dhe te huaj te perqendrojne kapitalet e tyre ne industrine ushqimore dhe ne ate te lehte, meqenese ato perbejne deget me rentabel te prodhimit industrial.

Nga tremujori ne tremujor, gjithnje e me shume, po evidentohet shuarja e degeve te tilla perpunuese si ajo ushqimore, tekstile dhe e kepuceve ne sektorin shteteror te ekonomise dhe transferimi i tyre ne sektorin privat te saj.

Sipas te dhenave te disponueshme, ne natyre, per sektorin shteteror te industrise, perjashtuar prodhimin e energjise elektrike, zerat e tjera paraqiten me kuota prodhimi dicka me te ulta se viti i kaluar. Procesi i privatizimit, koniukturat jo te pershtatshme te cmimeve, konkurrenca e huaj, mangesite organizative, vete te qenurit prone e shtetit, etj. numerohen si faktore te rendesishem prapa kesaj renieje te prodhimit.

Shqiperia eshte nje vend i pasur me burime ujore. Me nje mesatare vjetore prej 3080 m³ uje per fryme, Shqiperia renditet nder vendet me te pasura ne Evropen Lindore dhe Qendrore. Me shume se 92 per qind e ketij potenciali perdoret per prodhimin e energjise elektrike dhe ne te njejten kohe ky prodhim ze reth 40 per qind te totalit te prodhimit industrial. Gjate vitit 1996 prodhimi i energjise elektrike ka pasur nje rritje prej 34 per qind ne krahasim me nje vit me pare dhe, gjithashtu, eshte konstatuar nje rritje prej 11 per qind ne konsumin e energjise elektrike prej 850 milione KW/h.

Investimet ne sektorin e energjise kane shenuar shifren prej rreth 700 milione leke dhe jane mbuluar pothuajse falas nje shume prej 8 miliarde liretash te cilat jane investuar teresisht per permiresimin e sistemit te shperndarjes.

Dega me e rendesishme e prodhimit ne Shqiperi tani per tani mbetet **bujqesia** prodhimi i se ciles qe nga viti 1992 e ne vazhdim ze me teper se gjysmen e GDP-se. Gjate vitit 1996, sektori bujqesor dha nje kontribut ne masen 54 per qind te GDP nominale, duke shenuar pjesemarrjen me te larte se cdo ekonomi tjetere ne tranzicion. Privatizimi dhe liberalizimi i shpejte kane ndikuar fuqishem oferten e ketij sektori, rritja e se ciles nepermjet efektit te shumefishimit, ka luajtur rol te ndjeshem ne sektorin e fermereve si dhe ka vene ne levizje pershpjtimin e rritjes se ndertimit, tregtise, dhe sektorit te sherbimeve. Aktualisht ne bujqesi jane angazhuar 65 per qind e forcave te punes, fakt i cili nenvizon ndryshimet strukturore ne ekonomi te shkaktuara nga renia drastike e prodhimit industrial, pjesemarrja e te cilit ne totalin e punesimit ka rene ne 8 per qind nga 34 per qind ne vitin 1990.

Viti 1996 shenoi nje rritje ne masen 3 per qind te prodhimit bujqesor kundrejt 13.2 per qind ne vitin 1995. Ky ngadalesim ne ritmin e rritjes manifeston preferencen e fermereve shqiptare per te levizur nga prodhimi i bimeve te arave (grure dhe miser) ne ate te blegtorise. Krejt ndryshe nga viti 1995, kur blegtoria regjistroi nje rritje ne masen 3.6 per qind, gjate 1996 ky nensektor shenoi nje rritje ne rreth 9.5 per qind.

Sektori i ndertimit perben sektorin me rritje me te shpejte ekonomike qe nga viti 1993. Megjithese dicka me pak se ne vitin 1995, perseri sektori i ndertimit gjate vitit 1996 shenoi rritje te shpejte te prodhimit industrial me rreth 18 per qind. Volumi i ndertim-montimeve gjate vitit 1996 eshte rritur me shpejtesi duke kapur vleren prej 46.1 miliarde leke nga 38.5 miliarde leke qe ishte ne te njejten periudhe te vitit te kaluar, nderkohe Indeksi i kushtimit ne ndertim ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te meparshem eshte rritur 3 per qind. Rritja e prodhimit te pergjithshem industrial ne ndertim, ka ardhur kryesisht nga rritja e volumit te ndertimit. Keshtu numerohen rreth 3970 firma ndertimi ne vend, te cilat kane marre persiper ndertimin e 13400 apartamenteve dhe ndertesave sherbimesh³.

Eshte per tu shenuar qe nevojat per infrastrukture, rinovim banesash dhe ndertimesh ne pergjithesi do te sigurojne nje vazhdimesi te suksesshme te ketij sektori duke mundesuar nje rritje te kontributit te ketij sektori ne totalin e prodhimit te pergjithshem.

Transporti keto vitet e fundit ka marre nje zhvillim mjaft te madh si rezultat i liberalizimit ne nje shkalle te madhe te atij automobilistik dhe detar, i rritjes se aktivitetit tregetar si brenda vendit ashtu edhe me vendet e huaja, etj. Keshtu, ne periudhen 1991-1995, ritmi mesatar i rritjes se volumit te transportit ka qene

² Te dhenat nga DEDAC.

³ Informacion i Ministrise se Puneve Publike, Rregullimit te Territorit dhe Turizmit.

6 here me i larte se sa ne dekadën 1980-1990. Numri i automjeteve ne fund te vitit te kaluar u rrit me gati 8 here ne krahasim me vitin 1990. Persa i perket transportit detar 260 mije njerez hyjne e dalin nga Shqiperia cdo vit. Gjashte tragete hyjne ne portet tona cdo dite nga tre ne muaj qe ka qene numri i tyre ne vitin 1990. Persa i perket transportit ajror numri i pasagjereve ne fund te vitit 1996 ka qene 283 mije. Ne te njejten kohe investimet ne sektorin e transporteve jane rritur.

Zhvillimet e ndryshme, neper te cilat Shqiperia po kalon, kane diktuar rritjen ne sasi dhe cilesi te **nivelit te sherbimeve**, pa bere dallim ne llojin e tyre. Keshtu ne vitin 1996 ky sektor llogaritet te kete dhene 20 per qind te prodhimit te pergjithshem duke lene prapa dege te tilla si industria, transporti, etj. Vleresohet se sherbimet jane sektori me terheqes per investitoret e huaj, duke thithur rreth 80 per qind te investimeve te huaja.

Tregtia eshte shnderruar ne nje sektor jetik. Ne fund te 9-mujorit te pare ishine te rregjistruar rreth 29 mije persona fizike (rreth 59 mije te punesuar) te cilet mendohet se ne pjesen me te madhe ushtrojne aktivitetin e tyre ne fushen e tregtise.

Shqiperia konsiderohet si nje vend me potencial te madh **turistik**. Qe nga viti 1990 numri i turisteve te mberitur eshte rritur nga 10 mije ne 349 mije ne vitin 1996 dhe ne krahasim me vitin 1995 ky numer eshte rritur 15 per qind. Vleresohet qe gjate vitit 1996 te ardhurat nga turizmi u rriten me 18,1 per qind ne krahasim me vitin 1995, nivel ky pothuajse i njejte me ate vitit te kaluar.

Pa dyshim vemendje e vacante i eshte kushtuar sigurimit te nje sherbimi bashkekohor dhe efektiv ne **telekomunikacion**. Te ardhurat e siguruara nga Telekomia gjate vitit 1995 arriten ne masen 2478 milione leke, nderkohe qe vetem ne vitin 1996 u siguruan 3734 milione leke ose rreth 51 per qind me teper se sa te ardhurat e siguruara gjate vitit te kaluar.

Sic shihet gjate vitit 1996 jane rritur ndjeshem sherbimet ne telefoni dhe ato nderkombetare, prapa te cilave qendron nje zhvillim cilesor i arritur nepermjet investimeve te konsiderueshme ne kete sektor jetik per nje ekonomi te zhvilluar.

1.2 KERKESA E BRENDSHME DHE PRESIONET INFLACIONISTE

Me siper permendem qe ne fund te vitit Shqiperia perballonte nje pershpjetime ne rritjen e nivelit te pergjithshem te cmimeve te konsumit e shkaktuar kjo nga nje nivel tejet i larte i kerkeses se brendshme. Me konkretisht, ndersa vleresohet nje nivel i prodhimit te pergjithshem ekuivalent me 3 miliarde USD, llogaritet qe niveli i **agregatit te kerkeses** i matur si shume e totalit te shpenzimeve⁴ plus eksportin e mallrave dhe te sherbimeve te jete rreth shumes 4.1 miliarde USD. Krahasuar me vitin e kaluar, kemi nje rritje ne masen rreth 110 miliarde leke (1 miliarde USD) qe e shprehur ne perqindje do te thote 32 per qind.

Tabela 1.2. Prodhimi i Pergjithshem

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996
Prodhimi i Pergjithshem							
Ne milione leke me cmime te 1990	16813	12105	11235	12309	13331	15106	17225
Ndryshimi ne % mbi vitin e kaluar	-10,0	-28,0	-7,2	9,6	8,3	13,3	14,0
Ne milione leke me cmime aktuale	16813	16404	50697	125334	184396	229796	300806
Ne perqindje te GDP-se							
Totali i shpenzimeve	121,6	126,3
Exporti i mallrave dhe sherbimeve	12,2	12,2
Importi i mallrave dhe sherbimeve	33,8	38,5

Megjithte mungesen e te dhenave me te detajuara per kategori te tilla si investimet, konsumin, kursimet kombetare, etj., eshte e kuptueshme qe rritja e agregatit te kerkeses i dedikohet ne pjesen me te madhe rritjes se konsumit ndryshe nga tre vjetet e fundit kur kishim raporte me te harmonizuara te komponenteve te agregatit te kerkeses. Ekzistojne indikator te ndryshem te cilet e bejne te besueshem kete fakt. *Se pari*, statistikat e tregtise se jashtme tregojne qe ne fund te vitit 1996, vetem **16** per qind e totalit te importeve ishte ne formen e investimeve, pra pjesa kryesore i perket konsumit. *Se dyti*, rritja e shpenzimeve buxhetore nderkohe qe shpenzimet per investime kane mbetur pothuajse ne te njejtin nivel si ne vitin 1995. Keshtu, ne fund te vitit 1996 shpenzimet per investime perbejne 4.2 per qind te GDP-se nga 4.5 qe ato ishin ne vitin 1995. *Se treti*, dhe pa dyshim me i vecanti lidhet me lulezimin e skemave piramidale. Thuhet se ne keto skema u investuan shuma te konsiderueshme te cilat te konvertuara ne USD rreth vleresohen te jene rreth 1.5 miliarde USD. Duke marre si te mireqene se nje sasi e konsiderueshme e kesaj shume (le te themi 30 per qind) ka qene objekt i shperdorimit te vete ketyre firmave rentiere, pjesa tjeter qe ngelet (rreth 1.1 miliarde USD) eshte e barabarte me rritjen e agregatit te kerkeses gjate vitit 1996. Te ardhurat ne formen e interesit qe keto firma u paguanin huadhenesve, u drejtuan teresisht ne drejtim te konsumit, duke ndikuar ndjeshem nivelin e kursimeve kombetare.

⁴ Totali i shpenzimeve perbehet nga shuma e investimeve me totalin e konsumit.

Tabela 1.3. Tregues te Kerkeses se Brendshme

	1991	1992	1993	1994	1995	1996
Konsumi						
<i>Kons. duksh. energj.elektrike (Mln. Kwh)</i>	756	779	883	831
<i>Kons. dukshem i karburanteve (000/ton)</i>	256	534	421	218
Investimet						
<i>Volumi i ndertim montimeve (Mln. Leke)</i>	...	1.770	3.361	26.425	38.459	46.070
<i>Importet e makineri paisje (Mln.Leke)</i>	22.131	15.169	12.436	15.280
<i>Kons. i dukshem i cimentos (000/ton)</i>	307	293	456	674

Qe ekonomia te mbante prirjet e rritjes stabel qe ishte vene re per nje periudhe afatmesme qe nga fillimi i zbatimit te reformes ekonomike dhe gjate ketij viti ishte e nevojshme qe te zgjeroheshin **investimet** per te rritur mundesite prodhuese te ekonomise. Se bashku me politiken e vazhdimet te rritjes se investimeve nga sektori privat strategjia afatmesme ne fushen e investimeve u perqendrua ne cilesine e tyre duke u drejtuar ne aktivitetet intensive ne fushen e kapitaleve dhe teknologjive ne drejtim eksporti. Politika e investimeve inkurajoi, gjithashtu, edhe aktivite te tjera qe lidhen me politikat kerkimore te zhvillimit, percaktimit te tyre ne fushen e shperndarjes dhe te marketingut.

Nje numer i madh masash u moren per te realizuar nje klime te pershtatshme per investimet e brendshme dhe ato te huaja, duke u perpjekur qe te perqendrohen ato ne drejtim te prodhimit. Duke shqyrtuar rrjedhimet qe kane perqindjet e larta te investimeve ne bilancin e pagesave eshte marre parasysh po ashtu edhe perdorimi i tyre ne investimet per nje infrastrukture te zhvilluar. Me kete synim eshte punuar per te pasur nje bilanc pozitiv ndermjet investimeve qe kane per objekt rritjen e kapaciteteve dhe atyre te cilat japin direkt te ardhura dhe te mira nga shkembimet me vendet e huaja.

Duke u kthyer perseri ne nivelin e investimeve gjate vitit 1996, ato vazhduan te jene kryesisht nga sektori shtetor i cili pervec fondeve te veta, financohej kryesisht nga ndihmat me terma lehtesuese. Ne fund te vitit 1996 shpenzimet e bera per investime nga ana e buxhetit te shtetit llogariten ne 12.8 miliarde leke. Nga ana tjeter gjate vitit te kaluar ne formen e investimeve te huaja jane realizuar rreth 9 miliarde leke (90 milione USD) nderkohe qe rreth 5.1 miliarde leke te tjera (52 milione USD) jane financuar me kredi te huaj me terma lehtesuese. Investimet private⁵ jane rritur me ritme konstante dhe ne fund te vitit 1996 ato vleresoheshin ne rreth 7 per qind te GDP-se. Si total llogaritet qe niveli i investimeve ne fund te vitit 1996 te jete rreth 15 per qind e GDP-se.


Duke u ndalur ne ate pjese te kerkeses qe shkaktohet nga ekonomia boterore, duhet thene se gjate vitit 1996, megjithese ne shifra absolute, eshte vertetuar nje rritje ne masen rreth 8 miliarde leke, e shprehur ne perqindje te agregatit te kerkeses eksporti i mallrave dhe sherbimeve eshte rreth 1 pike perqindjeje me i ulet se ai i vitit te meparshem. Ky fakt edhe njehere konfirmon rritjen e madhe te kerkeses se brendshme, sidomos te konsumit privat.

⁵ Nuk perfshihet pjesa e investimeve private ne formen e investimeve direkte te huaja.

Sasia e mallrave dhe sherbimeve qe ekonomia shqiptare ofroi per plotesimin e kerkeses se rritur, perbente vetem 72 per qind te agregatit te kerkeses. Ishte kjo arsyjeja qe importet e mallrave dhe sherbimeve ne vitin 1996, shenuan rekord historik duke kaluar shumen 115 miliarde leke (1.1 miliarde USD). Perkeqesimi i bilancit korrent reflekton fazen e tanishme ne ciklin e investimeve. Si i tille c'ekuilibri i jashtem do te mund te permiresohet nese investimet do te drejtohen vecanerisht ne sektoret qe lidhen me eksportin te cilat do te mund te zbusin kerkesen agregate. Menaxhimi i ketyre investimeve ne menyre reale dhe prioritare do te siguroje per ekonomine nje mbeshtetje e cila me zhvillimin e saj do te mundesoje permiresimin e pozicionit te jashtem te vendit. Per kete duhet, gjithashtu, te ndermerren politika te orientuara per te zvogeluar importet, per te zgjeruar eksportet dhe per hapjen ne tregjet e huaja etj.

Kerkesa tejet e rritur nuk kishte si te kalonte pa lene gjurme ne nivelin e cmimeve te konsumit, nivel i te cileve ne fund te vitit 1996 ishte pothuaj 3 here me i larte se ai ne fund te vitit 1995. Duke pasur parasysh ndikimin e vonuar te ketij agregati, ndoshta pasojat e kesaj kerkese do te vazhdojne te ndihen akoma edhe per nje periudhe afatshkurter.

1.3 CMIMET E KONSUMIT




Graf. 1.4. Indeksi i Cmimeve te Konsumit
(viti 1993 = 100)

Ne kushtet e permiresimit te stabilitetit makroekonomik presioni mbi cmimet gjate vitit 1995 ishte me i vogel se gjate vitit 1994, gje qe solli nje zvogelim te nivelit te inflacionit nga 15 per qind gjate vitit 1994 ne 6 per qind ne fund te vitit 1995. Megjithate, edhe gjate vitit 1996, kontrolli i presionit te cmimeve vazhdoi te jete prioritar si rrezik per rritjen e inflacionit ne kushtet e nje vleresimi per nje rritje te shpejte ekonomike. Gjate kesaj perudhe patem nje rritje te kerkeses agregate qe nuk mund te kompensohej me burimet e brendshme d.m.th. me nivelin e prodhimit te brendshem. Kjo coi ne nje rritje te madhe te konsumit si ne sektorin publik ashtu dhe ne ate privat. Kjo rritje ne ndryshim me vitet e tjera nuk ishte e moderuar, por mjaft e larte. Per te vendosur ekuilibrin ne treg ndermjet kerkeses dhe ofertes, ne kushtet e nje oferte te zvogeluar sidomos per prodhime industriale, u desh qe te rritej ne permasa te medha importi i ketyre mallrave. Nderkohe eksporti ne pergjigje te kerkeses se ulet nga ana e tregjeve te huaja dhe te koniukturave jo te favorshme, mbeti ne te njejtat nivele si nje vit me pare. Keto zhvillime ne import dhe eksport paten ndikimin kryesor ne perkeqesimin e llogarise korrente d.m.th. ne rritjen e deficitit te saj.

Niveli i transfertave nga jashte i refugjateve tane mbeti pothuajse i pandryshuar ne krahasim me vitin e meparshem. Veprimtaria e skemave piramidale te huamarrjes arriti qe te thithe pjesen me te madhe te ketyre transfertave, gje qe krijoi premisa per luhatje ne treg. Gjate 6-mujorit te dyte te vitit 1996, tregu joformal pati pikun e aktivitetit te tij e per pasoje krijoi nje "psikoze" te caktuar ne sjelljen e konsumatoreve, prodhuesve dhe tregtuesve te mallrave. Kjo u shpreh edhe ne stabilitetin e monedhes sone kombetare dhe ne kurset e kembimit.

Ne kushtet e nje liberalizimi te vazhdueshem te cmimeve, te koniukturave te brendshme dhe nderkombetare te tyre, ne mesin e vitit 1996 u liberalizuan cmimet e artikujve te rendesishem te shportes sic ishin buka, dritherat, vaji i gurit dhe gazi.⁶ Nderkohe liberalizimi i tregtise se jashtme u shtri, pothuajse, ne te gjithet veprimtarine e saj.



Graf. 1.5. Indeksi Cmimeve te Konsumit
(ndryshimi 12-mujor ne %; fundi i perudhes)

Ne te njejten perudhe u prezantua edhe Tatimi i Vleres se Shtuar (TVSH), qe zevendesoi Tatimin e Qarkullimit. Baza mbi te cilen vepron TVSH-ja eshte me e gjere se sa ajo e Tatimit te Qarkullimit, gje qe krijon premisa per te ardhura me te medha fiskale. TVSH-ja ishte ne nivelin 12,5 per qind⁷.

Te gjithet keta faktore qe permendem me siper domosdo shkakuan presione mbi nivelin e pergjithshem te cmimeve, d.m.th. krijuan kushtet per rritjen e presioneve inflacioniste. Duke gjykuar inflacionin si nje fenomen shume te ndjeshem ndaj shpenzimeve buxhetore dhe ofertes se parase ne pergjithesi, duhet pranuar se

⁶ Mbeten te kontrolluara nga shteti, vetem cmimet e transportit publik dhe hekurudhor, tarifat postare, energjia elektrike dhe uji.

⁷ Niveli i TVSH-se i zbatuar tek ne eshte nder me te uletit ne Evropen Qendrore dhe Lindore.

gjate vitit 1996 shmangiet e ketyre te dy te fundit nga nivelet e programuara ishin te konsiderueshme dhe konsequencat e ketyre shmangieve detyrimisht dhane nje tjetër shmangie, ate te rritjes se nivelit te cmimeve te konsumit pertej objektivit te programuar.

Ne vend qe politika fiskale te luante nje rol te rendesishem shtese per te perforcuar politiken e shtrenguar monetare me qellim qe te kontrolloheshin presionet inflacioniste, ndodhi krejt ndryshe. Politika ekspansioniste e buxhetit te shtetit llogaritet te jete faktori percaktues ne shmangien e objektivit te ofertes se parase e per rrjedhim edhe ate te inflacionit. Fokusi i politikës fiskale duhet te ishte kujdesi dhe disiplina per te konsoliduar financat publike, ne menyre qe te reduktohej presioni i madh i kerkeses nga sektori publik, nderkohe qe ne anen tjetër duhej te bente cmos per te zvogeluar evazionin fiskal.

Krahasuar me fundin e 6-mujorit te pare te vitit 1996, cmimet e konsumit ne fund te vitit 1996 u rriten ne masen 9.5 per qind, duke bere qe rritja 12-mujore e **Indeksit te Cmimeve te Konsumit** te ndaloje ne nivelin 17.4 per qind. Po t'i referohemi programit per vitin 1996, duhet te theksojme se ky vit regjistroi nje norme inflacioni qe ishte rreth 5 pike perqindjeje me e larte nga c'ishite programuar⁸.

Tabela 1.4. Cmimet e Konsumit


(dhjetor 1993 = 100)

SHQIPERIA: Cmimet e Konsumit Dhjetor 1993 = 100%	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996
Indeksi i Cmimeve te Konsumit (CPI)	11,1	22,7	76,4	100,0	115,8	122,8	144,1
Ndryshimi 12-mujor i CPI-se, ne %	...	104,0	236,0	30,9	15,8	6,0	17,4
CPI (Perjashtuar efekti i sezonalitetit)	101,5	117,6	124,7	146,4
Ndryshimi 3-mujor; perqindje vjetore	13,0	17,4	16,9	8,5
CPI (perjashtuar buke dhe drithra)	100,0	119,5	128,0	144,4
Ndryshimi 12-mujor i CPI-se, ne %	19,5	7,1	12,7
Ndryshimi 3-mujor; perqindje vjetore	22,1	17,6	7,0
CPI (perjash. "ushqim, pije dhe duhan")	100,0	137,8	145,2	159,8
Ndryshimi 12-mujor i CPI-se, ne %	37,8	5,4	10,0
Ndryshimi 3-mujor; perqindje vjetore	-0,8	5,9	5,4


Ne kushtet kur edhe fundi i vitit 1996 shenoi nje rritje te GDP-se dyshifrore dhe ne perputhje me zhvillimin e treguesve makroekonomike kryesore si investimet, konsumi, papunesia, pagat etj, nje shmangie e tille eshte e shpjegueshme. Megjithate, duhet pranuar se, nje gjykim i plote per kete mund te behet vetem ne fund te nje cikli te plote zhvillimi.

Politika monetare e Bankes se Shqiperise gjate vitit 1996, ka qene me efektive si ne menyrat per arritjen e objektivave te saj ashtu dhe ne veprimet konkrete te ndermarrja. Ky efektivitete e ka bere ate me bindese dhe shume transparente. Keshtu, ne tregjet financiare ka ekzistuar bindja se vendimet e Bankes se Shqiperise


⁸ Duke u nisur nga vete specifikat qe paraqiste viti 1996 qe ne program ishte marre parasysh nje perqindje inflacioni ne nivelin 10 - 12 per qind, krahasuar me normen e inflacionit prej 6 per qind qe rezultoi ne fund te vitit 1995.




Graf. 1.6. Ndryshimi 12-mujor ne % i CPI-se



Graf. 1.7. Ndryshimi 3-mujor ne % i CPI-se
(perqindje vjetore; korigjuar nga efektet e sezonalitetit)



Graf. 1.8. Ndryshimi 3-mujor i CPI-se
(perqindje vjetore; matur me inflacionin "baze")



Graf. 1.9. Ndryshimi 12-mujor ne % i CPI-se
(Perjashtuar grupin "ushqim, pije & duhan")

kane qene te tilla qe kane ndihmuar ne kontrollin e inflacionit, gje qe ka shtuar besimin tek ajo. Me politiken e saj monetare Banka e Shqiperise gjithmone ka kontribuar per kete marreveshje midis te gjitha paleve qe veprojne ne ekonomine tone per te arritur nje objektiv te caktuar. Politika e saj ka bere qe objektivi i saj kryesor afatgjate i stabilitetit te cmimeve te sjelle dobi te shumta dhe te ndryshme edhe gjate vitit te fundit te programit te stabilizimit makroekonomik. Njekohesisht ajo ka qene e vetedijshme dhe ka pranuar se politika monetare ka kufizime te tilla, qe disa objektiva ne momente te caktuara dhe kushte te caktuara te brendshme dhe nderkombetare, duhet dhe mund te mos permbushen. Megjithate, objektivi themelor, kontrolli mbi oferten e parase eshte realizuar mire per nje periudhe afatgjate. Nga ana tjetere dihet se nje ekonomi me perqindje te ulet inflacioni eshte me e preferuar dhe me terheqese per investitoret e cdo lloj kategorie.

Perpjekjet e Bankes se Shqiperise po shtohen ne pikepamje cilesore dhe aty ku eshte e mundur edhe ne pikepamje sasiore qe te percaktohen lidhjet e drejta dhe te qendrueshme ndermjet treguesve te ndryshem makroekonomike (rritja ekonomike, inflacioni) dhe perqindjes se interesave. Keshtu, gjate vitit jane bere ndryshime te nivelit te interesave mbi baze te rritjes se inflacionit. Kjo rritje e interesave ka influencuar ne nje distance kohore mbi nivelin e cmimeve, sidomos duke patur parasysh edhe zhvillimet e sistemit piramidale te huamarrjes, procesin e riformimit te cmimeve apo edhe ndryshimin e kerkeses per para. Ne kushtet e prishjes se nje ekuilibri monetar, qe nenkupton raporte te caktuara te perberesve te agregateve monetare, veshtiresohet stabiliteti makro dhe mikroekonomik, madje brishtesia dhe paparashikueshmeria e zhvillimit te tyre rriten duke u bere shume te ndjeshem ndaj faktoreve te jashtem ose rastesore qe nuk mund te parashikohen ose qe mund te percaktohen ne kufij propabilitare pak te besueshem. Per kete arsye, Banka e Shqiperise eshte perpjekur qe te vleresoje ne kohe ndryshimet e ardhme qe mund te pesonin objektivat e ndryshem finale duke u njohur me faktoret e jashtem ose te brendshem, me faktin nese ata jane te perkohshem apo afatgjate si dhe cili do jete ndikimi i tyre ne kohe ne objektivat e caktuara dhe ne zhvillimet ekonomike ne pergjithesi. Ne kete pikepamje ajo eshte perpjekur te vleresoje ndryshimet pozitive ose negative te ketyre objektiveve sidomos kur eshte fjala per inflacionin per te bere qe ato te ndryshojne brenda kufijve te pranueshem, sepse dihet qe luhatje sado te vogla dhe ne dukje te parendesishme per shkak te paparashikueshmerise se tyre objektive mund te shkaktojne cballancime te medha mikro dhe makroekonomike.

Perpjekjet per te realizuar nje stabilitet cmimesh per nje kohe te gjate nuk do te thone detyrimisht se niveli i tanishem i inflacionit eshte i pranueshem. Nje aspekt i ketij problemi dihet qe eshte kostoja e mbajtjes se inflacionit ne nivele te pranueshme per nje kohe te gjate. Kjo d.mth. se cdo kompromis ndermjet inflacionit dhe papunesise sjell qe politika antiinflacioniste mund te jape nje rritje te perkohshme te papunesise.

1.4 PUNESIMI DHE TE ARDHURAT

Zhvillimet ne tregun e punes jane shume te rendesishme per mireqenien e shoqerise, familjes dhe individit. Kjo per shkak se pagat ne kushtet tona jane ende burim i rendesishem i te ardhurave, meqenese ne periudhen e kalimit ne ekonomi tregu per shkaqe te ndryshme nuk mund te garantohet punesimi i plote. Tendencat e tregut te punes pasqyrojne ristrukturimin e ekonomise si dhe rrugen e zhvillimit te metejsheem te saj qe lidhen me kalimin e pronesise, me ristrukturimin dhe rinovimin teknologjik te prodhimit etj.


Suksesi gjithnje e ne rritje i sektorit privat ne te gjithë sektoret e ekonomise, si dhe kushtet e reja social ekonomike te krijuara kane bere qe **Punesimi** te manifestoje arritje te konsiderueshme gjate 1996. Duke iu referuar te dhenave te 9-mujorit 1996, verejme se forcat e afta per pune kane mbetur pak a shume te pandryshuara ne krahasim me fundin e vitit 1995 duke pesuar nje renie te vogel prej 0,7 per qind.

I njeiti fenomen vihet re edhe me numrin e te punesuarve, megjithate struktura e tyre, duke ndjekur procesin e privatizimit ka ndryshuar ne favor te sektorit privat. Ne fund te 9-mujorit sektori privat punesonte 131 mije vete nga 117 mije qe ishin ne fund te vitit 1995, nderkohe qe perqindja e papunesise ne fund te 3-mujorit shenonte 12.4 per qind krahasuar me 13 per qind ne fund te vitit 1995. Numri i subjekteve⁹ fizike juridike private (ne sektorin jobujqesor) ka arritur ne 38489, ku subjektet e regjistruar si persona fizike zene 75 per qind te totalit dhe diferenca jane persona juridike.


Numri i te punesuarve ne sektorin shteteror eshte ulur me 4,2 per qind, nga 281 mije te punesuar qe ishin ne fund te 1995, ne 267 mije ne fund te 9-mujorit te pare te vitit 1996, nderkohe qe sektori privat bujqesor rregjistron numrin me te madh te te punesuarve me rreth 66 per qind te totalit te forcave te punes

Ekonomia shqiptare e cila ka hyre ne rrugen e transformimit drejt ekonomise se tregut me te dhenat e mesiperme reflekton tiparet e tranzicionit edhe ne strukturen e punesimit. Gjate ketyre viteve te fundit kane ndodhur shnderrime te medha ne drejtim te pronesise duke i dhene gjithnje e me shume hapesine, sektorit privat. Privatizimi ne sektorin bujqesor tashme ka mbaruar, ndersa ne ate jobujqesor procesi i privatizimit ka arritur ne fazen e tij perfundimtare ne ate te privatizimit te ndermarrjeve te mesme dhe te medha. Gjithashtu, emigracioni i vazhdueshem gjate ketyre viteve ka bere qe nje pjese e konsiderueshme e forcave aktive per pune te largohen nga Shqiperia.

Ne keto kushte zhvillimet e punesimit gjate vitit 1996 paraqiten si me poshte :



Graf. 1.10. Perqindja e Papunesise (Ne % te fuqise puntore; fundi i periudhes)



Graf 1.11. Struktura e punesimit ne fund te vitit '96

⁹ Sipas fundit te 6-mujorit te pare te vitit 1996.

Forcat e afta per pune kane mbetur pak a shume te pandryshuara ne krahasim me fundin e vitit 1995

Niveli i te **ardhurave** eshte veshtire te llogaritet ne te gjithë sektoret e ekonomise, megjithate vleresohet se niveli aktual i pagave eshte me i larte ne sektorin privat. Aktualisht disponohen te dhena vetem per pagat mesatare ne sektorin shteteror te cilat kane ardhur vazhdimisht duke u rritur. Gjate vitit 1995 rritja dy here e pagave solli nje rritje me te madhe se sa rritja e cmimeve per here te pare ne pese vjetet e fundit dhe ne fund te vitit paga mesatare mujore ishte 6568 leke. Gjate vitit 1996 vazhdoi me tej rritja e pagave ne sektorin shteteror me rreth 20 per qind duke bere keshtu qe pagat reale ne kete sektor te ishin rreth 25 per qind me te medha se ato ne fund te vitit 1990. Ne fund te 9-mujorit te pare 1996 niveli mesatar i pagave ne sektorin shteteror arriti ne 8044 leke ne muaj. Gjithashtu, ritmi i rritjes se pagave ne krahasim me ate te rritjes se inflacionit ka qene me i larte. Per tu shenuar eshte rritja per 33 per qind e pages minimale te miratuar.

Nga ana tjeter niveli i pagave ne sektorin privat vleresohet te kete ndjekur nje ecuri me ate te sektorit shteteror, me te vetmin ndryshim se niveli mesatar fillestar ka qene me i larte. Kjo diference ka mundesuar qe, megjithese rritja e pagave ne kete sektor ka ndjekur rritjet e bera ne sektorin shteteror te ekonomise, niveli aktual i pages mesatare te jete rreth 20 per qind me i larte ne sektorin privat. Vleresohet se pagat ne sektorin jobujqesor privat i kalojne pagat e sektorit shteteror per rreth 2-2,5 here. Duhet theksuar se njerezit po bejne perpjekje per burime te reja te ardhurash, pervec punesimit me page ne sektorin shteteror, sic jane fillimi i bizneseve te vogla, shitja ne rruge ose dypunesimi.

2. POLITIKA DHE ANALIZA MONETARE

2.1 OBJEKTIVAT E POLITIKES MONETARE

Politika Monetare ka qene guri themelor i programit te stabilizimit te ekonomise shqiptare qe nga fillimi i tij ne vitin 1993. Si pjese e strategjise se pergjithshme makroekonomike, edhe gjate vitit 1996, politika monetare e Bankes se Shqiperise ka qene ne funksion te parandalimit te presioneve te kerkeses se brendshme, per te realizuar nje kontroll sa me efikas mbi presionet inflacioniste ne ekonomi. Duke synuar kontrollin e presioneve inflacioniste ajo ka kontribuar ne ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, prishja e te cilit do te sillte perkeqesime ne rritjen e prodhimit, nivelin e punesimit, nivelin e investimeve, ne qendrueshmerine e monedhes kombetare dhe te tregjeve ne pergjithesi etj. Nje drejtim tjetër ka qene ndjekja e politikave te pershtatshme makroekonomike per te siguruar qe kerkesa e tepert te mos perkeqesoje pozicionin e jashtem te vendit.

Deri ne mes te vitit 1995 Banka e Shqiperise kontrolloi oferten e parase nepermjet perdorimit te kufijve te kreditit mbi gjithë sistemin bankar. Me tej Banka e Shqiperise vendosi nje objektiv mbi agregatin monetar M3 ne te cilin deficiti i qeverise eshte i dhene dhe perpjekjet per te kontrolluar rritjen e M3 perqendrohen ne kombinimin e kufijve te kreditit mbi kredite tregtare dhe rregullimeve te perqindjeve te interesit mbi depozitat bankare. Ne lidhje me politiken e perqindjes se interesit objektivi i Bankes se Shqiperise ka qene mbajtja e tij ne nivele pozitive ne terma reale per te shmangur ndermjetesimin jashte bankar dhe zevendesimin e monedhes.

Ecuria e pergjithshme e politikës monetare, e gjykuar nga ecuria e inflacionit, eshte per tu pershendetur. Perqindja e inflacionit ne fund te vitit 1995 u reduktua ne 6.8 per qind nga 15.9 dhe 31 per qind qe ishte respektivisht ne vitin 1994 dhe 1993. Megjithate kurba ne renie e inflacionit¹⁰ nuk u arrit edhe ne fund te vitit 1996, kur perqindja e tij u rrit perseri duke shenuar 17.3 per qind. Rritja e forte e deficitit buxhetor mbeti kontributi kryesor ne rritjen e parase gjithsej, rritje e cila ushtroi presionie te forta mbi politiken monetare.

¹⁰ Ne programin monetar te vitit 1996, ashtu si edhe ne tre vjetet e fundit, si objektiv final u vu stabiliteti i cmimeve te konsumit, rritja e arsyeshme e prodhimit te pergjithshem si dhe nje llogari korrente e balancuar. Ne arrijten e ketyre objektiveve, pa dyshim, kontrolli mbi oferten e parase dhe deficitin buxhetor do te ishte vendimtar. Ne kete kuader Banka e Shqiperise ne programin e saj monetar si instrument operacional vendosi kontrollin e agregatit M3.

Me konkretisht, per te mbeshtetur nje rritje prodhimi ne masen 8 per qind, nje norme vjetore inflacioni ne masen 12 per qind u pa e arsyeshme nje rritje e agregatit M3 ne masen 22 per qind. Kjo rritje e ofertes se parase do te behej ne kushtet kur parashikohet nje deficit buxhetor ne masen 8 per qind te GDP-se (kredia direkte e Bankes se Shqiperise do te ishte 5.1 miliarde leke) si dhe nje nivel i pandryshueshem ne mjetet valutore te Bankes se Shqiperise.

Zhvillimet ekonomike te vitit 1996, demonstruan qe kontrolli i Bankes se Shqiperise mbi oferten e parase, dhe keshtu mbi inflacionin, eshte mjaft i veshtire ne kushtet e nje deficiti fiskal te tej rritur. Nga ana tjeter, gjate ketij viti ne Shqiperi filloi te intensifikohej veprimtaria e shume firmave qe ne baze te tyre kishin lojen piramidale. Per vete menyren se si funksionuan keto firma, fundi i tyre do te ishte shume i shpejte dhe do te rendonte shume gjendjen e popullsisë.

Veprimtaria e ketyre firmave pati shume ane negative, jo vetem ne pikepamjen sociale duke ushqyer pasivitetin, por edhe ekonomike, duke frenuar investimet ne ekonomi, si dhe duke shkaterruar kursimet financiare. Ndersa ne sistemin bankar, ajo e rendoi me tej gjendjen e bankave jo vetem si rezultat i rënies se ritmit te rritjes se depozitave, dhe ne disa muaj dhe ne uljen e tyre, por dhe ne tronditjen e besimit te publikut, qe eshte aq i nevojshem per te. Nga ana tjeter kjo veprimtari veshtiresoi shume dhe kontrollin nga ana e Bankes se Shqiperise te situates monetare, duke lejuar kalim dhe levizje te medha te parase jashte kanaleve bankare. Vendosja e interesave mbi cdo llogjike ekonomike, coi ne kanalizimin e te gjitha kursimeve te popullates, aftesive investuese te saj, ne keto firma piramidale. Ndersa veprimtaria investuese e ketyre firmave ishte pothuajse e paperfillshme, gje qe paralizoi thujtjese plotesisht ekonomine, duke ulur veprimtarine prodhuese te saj.

Duke e ndare vitin 1996 ne dy periudha shkurtimisht do te thoshim se per 6-mujorin e pare te vitit karakteristike ishte rritja e Parase Gjithsej, gje e cila justifikohet pjeserisht me rritjen ekonomike dhe pjeserisht me rritjen e deficitit buxhetor si dhe te kredise per ekonomine. Krejt ndryshe ne 6-mujorin e dyte sidomos ne muajt tetor, nentor kemi nje zhvendosje te konsiderueshme ne komponentet perberes te agregatit M3. Gjate ketyre dy muajve, periudhe e cila perkon me pikun e ekspansionit te tregut joformal raporti para jashte banke/depozite, u ul ndjeshem nga 0.620 qe ishte ne janar te vitit 1996 ne 0.448 ne dhjetor te ketij viti. Paraja mbeti pothuajse e gjitha po ne keto firma, ku popullsia rikapitalizonte dhe interesat dhe principalin. Kjo rrjedhje pjeserisht futej perseri ne sistemin bankar nepermjet llogarive qe kishin keto firma ne banka. Ne fund te muajit dhjetor 1996 paraja ne qarkullim krahasuar me fundin e muajit shtator ishte rreth 6.9 per qind me e ulet, nderkohe qe depozitat pa afat per te njejeten periudhe u rriten ne masen 80 per qind.

2.2 INSTRUMENTET MONETARE

2.2.1 INSTRUMENTET DIREKTE

Instrumentet e politikës monetare janë variabla nën kontrollin e Bankës Qendrore të cilat mund të përdoren për të ndikuar tregjet financiare dhe monetare për të arritur objektivat finale të politikës monetare. Instrumentet e politikës monetare janë dy llojesh: indirekte dhe direkte. Instrumentet indirekte janë ato që ndikojnë në variablat e ndryshëm financiar, duke ndikuar fillimisht në rezervën e parase.

Edhe gjatë vitit 1996, Banka e Shqipërisë për arritjen e objektivave të saj të politikës monetare, vazhdoi të mbështetet në përdorimin e instrumenteve direkte, kombinuar me instrumentet indirekte, e kushtëzuar kjo nga vete situata dhe kushtet e sistemit të bankar. Masa e kreditit vazhdoi të kontrollohet përsëri nga **kufiri i kreditit**, aplikuar për çdo bankë mbi bazën e kreditit neto në sektorin joshpetor, si një instrument shumë i rëndësishëm për kontrollin e ofertës së parase. Mbajtja e një kufiri të shtrenguar të kredive për ekonominë u bë e domosdoshme për të harmonizuar dhe neutralizuar efektet negative të një konsumi të madh kredie nga qeveria si dhe për t'i paraprirë presioneve inflacioniste që do të kishte rritja e kërkesës për kredi. Kufizimi i kredive për ndermarrjet shtetërore si dhe sektorin privat u bë në nivele që të përputheshin me aftësinë thithëse të ekonomisë, duke patur parasysh pjesën e thithur nga qeveria për të financuar deficitin e lartë buxhetor.

Në përgjithësi Banka e Shqipërisë është përpjekur që të kryejë shpërndarjen e këtij kufiri krediti sipas bankave duke ia përshtatur nevojave të tyre jo vetëm sipas tremujoreve por edhe gjatë gjithë periudhës, duke bërë ndryshimet dhe adaptimet e nevojshme në përputhje me nevojat dhe zhvillimet monetare. Gjithashtu, për t'iu përshtatur nevojave me kredi të bankave, është përdorur edhe tregtimi i kufirit të kreditit midis bankave. Shpërndarja e kufirit të kreditit është bërë duke patur parasysh objektivat e politikës monetare si dhe duke bërë të mundur kontrollin e ofertës monetare.

Kështu gjatë vitit 1996, u shpërnda një kufi krediti në masën 3070 miliona leke, një shpërndarje kjo pothuajse e njëtrajtshme sipas tremujoreve, nga e cila u realizua 2581 miliona leke ose 84 përqind e saj. Kryesisht kjo kredi iu akordua sektorit privat, individëve, ndermarrjeve të përbashkëta, duke inkurajuar në këto mënyra investimet dhe bizneset e ndryshme.

Banka e Shqipërisë, për moszbatimin e këtij kufiri ka aplikuar masa penalizuese në baza të rregullores përkatëse të Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimet e inflacionit, siç u përmenden dhe në pjesën e parë të kapitullit, e detyruan Bankën e Shqipërisë të ndjeke me kujdes **perqindjet e interesit**, politike e cila mund të jetë faktori kryesor në minimizimin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Në stadin e tanishëm të zhvillimit të ekonomisë, janë bërë përpjekje që

krahas kontrollit te tyre nepermjet nje politike elastike per te pasqyruar ndryshimet ne treguesit makroekonomike si dhe ne ata financiare te merren parasysh po ashtu edhe ndikimet e zhvillimeve ne treg. Keshtu qe mund te thuhet se ne ndryshimet qe kane pesuar perqindjet e interesit kohet e fundit jane kombinuar mjaft mire ndikimi administrativ me ate te tregut. Duke u nisur edhe nga parimi se perqindjet e larta te interesit nuk jane thjesht tregues te nje oferte te pamjaftueshme parash, por rezultat i veprimit te nje numri te madh faktoresh, ato kohet e fundit po perdoren si nje mekanizem efikas transmisioni te politikës monetare. Zhvillimet monetare te vitit 1996 tregojne se jane rritur kerkesat e konsumatorve, investitorve dhe te qeverise per kredi, gje qe e tregon tejkalimi i kufirit te kredise nga ana e bankave tregtare, rritja e deficitit buxhetor etj. Keto zhvillime qe pasqyrohen edhe ne treguesit makroekonomike kane bere te domosdoshem ndryshimin e perqindjeve te interesit me nje frekuence me te larte se me perpara ne drejtim te rritjes se tyre.

Tabela 2.1. Perqindjet e Interesit

(Fundi i periudhes, perqindje vjetore)


	1993	1994	1995	3m-96	6m-96	9m-96	1996
Perqindja rifinancimit	34,0	25,0	20,5	20,5	20,5	24,0	24,0
Perqindja e remunerimit	...	13,5	5,0	-	-	-	-
Perqindjet e depozitave 1/							
12-M	23,0	16,5	13,7	13,8	16,5	19,1	19,1
Perqindjet e kredise 2/							
12-M	30,0	20,0	21,0	20,7	24,8	26,1	28,8
Perqind. e letrave me vlere							
Bono thesari 3/							
3-M	...	10,0	14,7	14,0	17,9	19,9	21,1
6-M	...	12,1	14,9	14,8	18,1	22,0	22,3
12-M	15,1	15,0	18,4	22,0	22,5
Obligacione te Qeverise	23,8	15,1	14,3	13,6	13,5	16,2	18,0

1/ Para Tetorit '95 interesi i depozites tregon nivelin minimum te bandes se vendosur nga Banka e Shqiperise. Nga Tetori '95 interesi i depozites tregon mesataren e ponderuar per depozitat e reja me maturim 12 muaj.


2/ Para Tetorit '95 interesi i kredise tregon perqindjen kufi te vendosur nga Banka e Shqiperise. Nga Tetori '95 interesi i kredise tregon mesataren e ponderuar per kredite e reja me maturim 12 muaj.

3/ Interesi mesatar i ponderuar i ofertave te pranuar ne ankandin me te fundit te Bonove te Thesarit per periudhen.

Mungesa e nje tregu te mirefillte te parase si dhe ekzistenca per nje kohe te gjate e nje niveli relativisht te larte te rezervave te teperta, i dhane perqindjes se interesit per depozitat me maturim 12-mujor atributin e perqindjes baze te interesit, rregullimi i te cilave eshte subjekt i vendimit administrativ te Bankes se Shqiperise. Pas nje periudhe relativisht lehtesuese ku perqindja e interesit per depozitat me maturim 12-mujor shenoi nivelin me te ulet te kater vjeteve te fundit ne 12,5 per qind, Banka e Shqiperise gjate periudhes prill-shtator te vitit 1996, mbi bazen e zhvillimeve aktuale si dhe ne ndikimin e ardhshem te tyre ne kerkesen reale dhe prodhimin si dhe ne ecurine e pritshme te inflacionit beri ndryshimet e nevojshme ne perqindjet e interesit te depozitave me afat maturimi 3, 6 dhe 12-mujor me respektivisht 8.5, 7 dhe 8 pike perqindjeje. Ashtu sic pritej, ndryshimet ne perqindjet e interesit per depozitat, ndikuan edhe ne interesat mesatare te bonove te thesarit, kredise, tregut nderbankar etj.



Graf. 2.1. Perqindjet e Interesit
(Ndryshimi 12-mujor i Depozitave me Afat)



Graf. 2.2. Perqindjet e Interesit
(Perqindje vjetore; Inflacioni 12-mujor)

Meqe deri tani analizuam vetem perqindjet e interesave nominale me te cilat njihet edhe publiku i gjere, le te ndalemi per te njejten periudhe edhe te perqindjet e interesave ne terma reale.

Pavaresisht se viti 1996 regjistroi ecuri te ndryshme ne komponentet perberes te totalit te depozitave te sistemit bankar, duhet thene se ne politiken e saj Banka e Shqiperise ndermjet te tjerash ka synuar sigurimin e nje besimi publik te qendrueshem ne sistemin bankar. Mungesa e ketij besimi do te sillte crregullime ne sigurimin e funksionimit normal te nje sistemi bankar te shendoshe. Mungesa tij, duke ulur thithjen e depozitave, do te dobesonte jo vetem sistemin bankar ne vetvete, po dhe ekonomine ne teresi, sepse bankat nuk do te ishin ne gjendje ta mbeshtesin ate me investime. Nga ana tjetere, megjithe presionet e forta te tregut joformal, Banka e Shqiperise i mbajti interesat ne nivele optimale, qe do te thote nje rritje e tyre aq sa e impononte niveli i inflacionit, per te mos paralizuar investimet ne ekonomi.

Mbajtja e interesave reale ne nivele pozitive te pranueshme permes rregullimit gradual te interesit nominal ne perputhje me uljen e inflacionit dhe zhvillimet e tjera ekonomike dhe monetare eshte nje nga principet kryesore qe udheheqin politikene monetare te Bankes se Shqiperise. Konsideratat kryesore te kesaj politike konsistojne ne faktin qe niveli i larte i interesave nuk nxit dhe nuk inkurajon investimet dhe prodhimin meqenese kostoja e huamarrjes behet edhe me e larte. Gjithashtu, nje nivel i larte interesash ka efekte frenuese e perkeqesuese edhe per sistemin bankar, kostoja e te cilit rritet ndjeshem. Nga ana tjetere nje nivel i ulet interesash nuk mund te siguroje kursimet e mjaftueshme ne ekonomi, te cilat te mund te perdoren per te siguruar investime te qendrueshme ne periudha afatmesme dhe afatgjata. Ne percaktimin e nivelit te interesave eshte pasur parasysh edhe procesi i liberalizimit te plotte te cmimeve duke nxjerrre ne analize edhe efektet e inflacionit te fshehur.

Duke analizuar perqindjet reale te interesave gjate kesaj kohe veme re dy pamje te ndryshme. Ne tremujorin e pare ato kane pesuar luhate, gje qe mund te shpjegohet edhe me nje sere faktoresh me ndikim te vonuar qe huazohen nga viti i kaluar, ndersa ne vazhdim ato kane pesuar zvogelim (tabela e interesave).

Sipas zhvillimeve te fundit monetare pritet qe perqindjet e interesit te vazhdojne te rriten, te pakten per nje periudhe afatshkurter, duke bere te detyrueshme vazhdimesine e nje shtrengimi te metejshe te politikes monetare. Veprimi i vonuar i ndryshimeve monetare mbi ekonomine dhe treguesit makroekonomike ne pergjithesi si dhe veshtiresia ne parashikimin per nje periudhe afatgjate te ndryshimeve ne perqindjet e interesit imponojne kete rritje.

2.2.2 INSTRUMENTET INDIREKTE

Rezerva e detyrueshme, si nje nder instrumentet indirekte te politikes monetare, eshte perdorur nga ana e Bankes se Shqiperise me efektivitet per kontrollin e ofertes monetare, duke permendur ketu edhe permiresimet ne procedurat e zbatimit me rigorozitet te ketij instrumenti. Edhe gjate vitit 1996, te gjitha

bankat e nivelit te dyte, ashtu si dhe gjate vitit 1995, kane qene te detyruara te depozitojne prane Bankes se Shqiperise 10 per qind te totalit te depozitave ne leke dhe ne valute si rezerve te detyrueshme. Pra, norma e rezerves se detyrueshme mbeti 10 per qind dhe kjo e fundit nuk eshte remuneruar si dhe me pare.

Ecuria e rezerves se detyrueshme si ne leke ashtu dhe ne valute ka patur pothuaj te njejten tendence ne rritje ashtu si dhe vete tendenca e depozitave. Gjithashtu, per mosplotesim te rezerves se detyrueshme nga ana e bankave te nivelit te dyte Banka e Shqiperise vazhdon te aplikojte gjoba me norma interesi penalizuese.

Sic dihet ky instrument, i koordinuar dhe me instrumentet te tille si kredia Lombard, transaksionet e shitblerjes se bonove te thesarit ne tregun sekondar etj, ka sherbyer dhe vazhdon t'i sherbeje vete bankave si amortizator per drejtimin ditore te fondeve si dhe per shlyerjen e pagesave nderbankare ditore. Kjo dukuri eshte vene re kryesisht gjate 6-mujorit te dyte te vitit 1996¹¹ dhe eshte perdorur kryesisht ne ato raste kur bankat nuk kane qene ne gjendje te marrin pjese ne tregun sekondar. Perdorimi i rezerves se detyrueshme ne rastin e mungeses se likuiditetit nga Banka e Shqiperise ka inkurajuar bankat e nivelit te dyte ne uljen e kostos se huamarrjes se tyre.

Rifinancimi, kredia LOMBARD dhe tregu financiar.

Likuiditeti eshte nje element kyc, shume i rendesishem i politikës monetare, nepermjet te cilit behet e mundur qe bankat e nivelit te dyte te mund te perballojne nevojat e tyre ditore me likuiditet si dhe transaksionet e pagesave.

Gjate vitit 1996, Banka e Shqiperise ka vazhduar te kontrolloje ne menyre te perditshme dhe te perdore instrumentet e saj te politikës monetare per te permbushur nevojat e likuiditetit te bankave te nivelit te dyte. Keshtu rifinancimi si nje instrument indirekt i politikës monetare dhe shume penalizues, i cili ndikon pa dyshim ne nivelin e kredise se sistemit bankar si dhe ne kontrollin e likuiditetit, pothuajse nuk u perdor fare. Duke mbartur perqindjet me te larta te interesit, rifinancimi u zevendesua nga nje perdorim me i gjere i kredise Lombard, dhe kryesisht ne gjysmen e dyte te vitit 1996. Pikerisht perqindja e larte e rifinancimit i beri bankat te perdorin ne menyre me efikase facilitetet e tjera te tilla si Kredia Lombard apo transaksionet ne tregun sekondar te bonove te thesarit.

Kuptohet qe dhe keto lehtesira u sherbyen bankave te nivelit te dyte per te siguruar likuiditetet e nevojshme, ne kushtet e veshiresive financiare, pasi ato nuk kishin ndonje mundesi tjeter, duke e perdorur kete te fundit si burim te fundit financimi. Por ne te njejten kohe, perdorimi sa me me fleksibilitet i instrumenteve te politikës monetare nga Banka e Shqiperise u sherbeu atyre per te menaxhuar me mire riskun.

¹¹ Rezerva e detyrueshme eshte perdorur per here te pare nga BTA per mbulimin e gjendjes debitore te llogarise rrjedhese te kesaj banke.

Pra, jane pikerisht keto instrumente, nepermjet te cilave Banka e Shqiperise ofroi mundesi me fleksibile dhe terheqese per likuiditetet, duke thithur ose furnizuar me likuiditet tregun e brendshem sipas nevojave te tij. Per vitin 1996, kredia Lombard eshte aplikuar kryesisht per Banken Tregtare Agrare dhe per Banken e Kursimeve, kundrejt kolateraleve te vena prane Bankes se Shqiperise. Kredia Lombard per kete vit arriti shumen 564 milione leke. Ne 80 per qind te rasteve, meqenese bankat nuk iu pergjigjen dot kthimit ne kohe te kesaj kredie, atehere ato humben kolaterale te cilat kaluan ne portofolin e Bankes se Shqiperise. Interesat per kredine Lombard u luhaten ne varesi te interesave 3-mujore te ankandeve te fundit te bonove te thesarit¹². Keshtu aplikimi i kesaj kredie i siguroi Bankes se Shqiperise nje interes ne masen 3.45 milione leke dhe bono thesari ne portofolin e saj 304.5 milione leke.

Duhet theksuar qe Banka e Shqiperise e perdori kete instrument ne rastin e nje menaxhimi jo te mire te fondeve nga ana e ketyre bankave dhe duke patur parasysh limitet e Bankes se Shqiperise per blerjet e bonove te thesarit ne tregun sekondar.

Nje burim tjetër i ofertes se rezervave jane dhe rezervat jo te huamarra, te cilat kane te bejne me kontrollin e perditshem nga Banka e Shqiperise te rezervave te bankave te nivelit te dyte nepermjet operacioneve ne tregun sekondar (shitblerjes se letrave me vlere, bono dhe obligacione). Keto operacione jane zhvilluar me pjesemarrjen jo vetem te bankave te nivelit te dyte por dhe me pjesemarrjen e drejtperdrejte te Bankes se Shqiperise. Nga kjo pjesemarrje Banka e Shqiperise siguroi nje te ardhur nga interesat ne masen 508 milione leke. Kryesisht pjesemarrja e Bankes se Shqiperise ne operacionet e tregut sekondar ka ardhur si pasoje e gjendjes se veshtire financiare te bankave me kapital shteteror te here pas hershme, domethene nga nje menaxhim jo i mire i fondeve te tyre. Duhet permdur fakti qe ndonjehere Banka e Shqiperise ka blere bono thesari ne tregun sekondar jo vetem per likuiditete, por edhe per financimin e deficitit buxhetor nga ana e bankave. Pra, deficitit buxhetor eshte financuar jo vetem nga blerja e bonove te thesarit ne tregun primar por dhe ne tregun sekondar. Gjate muajit tetor dhe nentor te ketij viti, Banka e Shqiperise i ka shitur me shume Bankes Kombetare Tregtare bono thesari ne tregun sekondar, pasi ne kete periudhe kjo banke ka patur likuiditet te tepert per shkak te depozitimeve te firmave te tregut joformal.

Persa i perket interesave, ne shitblerjet midis bankave ato jane vendosur ne nivelet e tregut ndersa me pjesemarrjen e Bankes se Shqiperise ato jane percaktuar ne baze te rregullores se saj.

Gjithashtu, transaksionet e zhvilluara ne tregun sekondar kane qene shume me te medha se sa ne Bursen e Tiranes per faktin se ato te parat i pergjigjen ne kohe dhe menjehere nevojave te bankave te nivelit te dyte. Banka e Shqiperise ka planifikuar te tregtoje bono thesari me marreveshjen e riblerjes REPO, gje e cila

¹² Aplikimi i interesave per kredine Lombard bazohet ne Njoftimin Zyrtar perkates te Bankes se Shqiperise.

do t'i lejoje bankat te menaxhojne me se miri pozicionet e tyre te likuiditetit ne menyre me fleksibel dhe me kosto me te ulet.

2.3 BAZA MONETARE DHE PARAJA GJITHSEJ

2.3.1 BAZA MONETARE

Paraja ne qarkullim. Duke pare ecurine e parase ne qarkullim gjate vitit 1996 vihet re qe pas nje rritje graduale te vazhdueshme deri ne muajin shtator, per here te pare nga tetori ky tregues fillon te bjere, duke shenuar nje rritje vjetore ne masen 17.7 per qind. E krahasuar me vitin 1995, kjo rritje eshte shume e vogel dhe ne vetvete, ashtu si thame dhe siper, pasqyron veprimin e tregut joformal.


Ne kapitullin e pare dhe paragrafet e mesiperm, kemi folur per nje rritje te konsiderueshme te totalit te depozitave, vecanerisht gjate periudhes 2-mujore tetor-ntor 1996. Pervet te tjerave, kjo rritje e madhe e depozitave shkaktoi edhe nje rritje te nivelit te **rezerves se detyrueshme**¹³, i cili ne fund te vitit 1996 numeronte rreth 9.2 miliarde leke, nje shifer kjo rreth 2 here me e larte se ajo e vitit te meparshem.

Krejt ndryshe nga rezerva e detyrueshme, gjendja e **rezervave te teperta** nga 5.5 miliarde leke ne fund te dhjetorit 1995, arriti ne 2 miliarde ne fund te vitit 1996. Gjate vitit Banka e Shqiperise synoi ne mbajtjen e rezervave te teperta ne nivele minimale operacionale, duke ofruar rezerva te reja ne sistemin bankar ne shumate e domosdoshme per te plotesuar kerkesat e qeverise dhe ekonomise per kredi. Niveli i arritur per rezervat e teperta pasqyron gjendjen e nevojshme te bankave tregtare per kleringun midis tyre dhe per pagesat e publikut ne *cash*. Keto arritje gjate vitit 1996 jane bere ne kuadrin e perpjekjeve qe po ben Banka e Shqiperise per menaxhimin me te mire te likuiditetit te sistemit bankar.


Mbi bazen e sjelljes vjetore te komponenteve te mesiperm **baza monetare** ne fund te vitit 1996 arriti 61.4 miliarde leke. Ky nivel i ri i baze monetare do te thote nje rritje vjetore ne masen 14 per qind nderkohe qe njekohesisht do te thote nje renie ne masen 3.7 miliarde leke nga niveli i parapare ne programin monetar te vitit 1996.

2.3.2 PARAJA GJITHSEJ


Zhvillimet monetare gjate vitit tregojne per nje rritje te parase gjithsej ne masen 43.8 per qind krahasuar me 52 per qind dhe 28 per qind qe ishte respektivisht ne vitin e meparshem dhe ne programin monetar.



Graf. 2.3. Baza Monetare
(Ne milione leke)




Graf. 2.4. Shpejtesia e Parase
(ne here)



Graf. 2.5. Paraja Gjithsej
(Ne milione leke)

¹³ Ky dyfishim i nivelit te rezerves se detyrueshme ne total i dedikohet teresisht rritjes se baze se rezerves, nderkohe qe perqindja e aplikuar mbi kete baze mbeti e pandryshuar ne kuoten 10 per qind.



Graf. 2.6. Paraja gjithsej dhe Inflacioni
(Ndryshimi vjetor ne %; fundi i periudhes)

E pare nga ana e ofertes se parase kontributin kryesor ne rritjen e parase gjithsej e ka dhene agregati M1 i cili ne fund te vitit 1996 llogariste me shume se 59.3 per qind te saj, ose rreth 4 pike perqindjeje me shume se ne vitin e meparshem. Ne fund te vitit 1996, ndersa agregati M1 regjistroi nje rritje ne masen 52.6 per qind, pjesa e mbetur¹⁴ e parase gjithsej u rrit vetem 33 per qind. Diferenca ne ritmin vjetor te rritjes se agregatit M1 me pjesen tjetere te parase gjithsej duket edhe ne renien e madhe te shpejtesise se parase te matur me agregatin M1, nderkohe qe shpejtesia e matur me dy agregatet e tjere ka pesuar nje renie me te moderuar me afersisht 0.25 pike perqindjeje.

Tabela 2.2. Agregatet Monetare

(Ne milione leke; fundi i periudhes)

	1991	1992	1993	1994	1995	1996
Paraja Jashte Bankave	4439	9897	17990	27627	41906	47814
Depozita pa Afat	5430	7266	10411	11140	17346	42591
Agregati M1	9869	17163	28401	38767	59252	90405
Depozita me Afat	1363	4764	11705	18705	28117	30240
Agregati M2	11232	21927	40106	57472	87370	120646
Depozita ne Valute	152	6844	10248	13304	20080	33906
Agregati M3	11384	28771	50355	70775	107449	154552
Paraja Jashte Bankave ne % te M1	45	58	63	71	71	53
Depozita pa Afat ne % te M1	55	42	37	29	29	47
Agregati M1 ne % ndaj M3	87	60	56	55	55	58
Agregati M2 ne % te M3	99	76	80	81	81	78
Agregati M3 = 100 %	100	100	100	100	100	100

Sjellja e elementeve perberes te M1 gjate vitit 1996, eshte krykeput e ndryshme per secilin komponent me vete. Ndersa paraja jashte bankave e krahasuar me dhjetorin 1995 ka nje rritje shume te ulet, depozitat pa afat kane regjistruar nje rritje vjetore rekord me 2.4 here. Ky fakt reflektohet ne uljen e raportit para jashte bankave/totali i depozitave i cili nga 0.63 ne fund te vitit 1995 ne dhjetor te ketij viti arriti ne 0.46. Ne themel te kesaj permbysjeje qendron veprimtaria e intesifikuar ne periudhen 2-mujore tetor-entor e skemave piramidale. Tashme eshte i njohur fakti se ne tremujorin e fundit te vitit 1996 per shkak te normave te larta te interesave qe keto skema aplikonin, u thithen kursimet e nje mase te madhe njerezish duke ulur masen e parase jashte bankave dhe duke rritur depozitat pa afat.

Struktura e depozitave pa afat sipas sektoreve te ekonomise tregon per nje rritje shume te madhe te sektorit privat ne 3-mujorin e fundit te vitit, e cila ne masen me te madhe pasqyron jo vetem zhvillimin e biznesit privat por dhe hyrjet e medha te parase ne llogarite rrjedhese te firmave rentiere. Ne vitin

¹⁴ Behet fjale per totalin e depozitave me afat dhe atyre ne valute, qe ndryshe njihet si pothuajse paraja.

1996, depozitat pa afat ne Leke u rriten fuqishem me rreth 145 per qind. Rritja drastike e depozitave pa afat si perqindje e GDP-se ne 15.4 per qind nga 7.5 per qind ne vitin 1995 eshte nje tjetër fakt qe konfirmon kete fenomen eksepsional. Eshte e kuptueshme qe kjo rritje reflekton nje magnitudo ne rritje te sektorit joformal qekurse pjesemarresit e ketij tregu vendosen shuma jashtezakonisht te medha ne formen e depozitave ne bankat tregtare.


Si shume gjera te tjera edhe depozitat me afat nuk munden t'i shpetonin skemave piramidale. Ndryshe nga vitet e meparshem, depozitat me afat¹⁵ u rriten vetem 7.5 per qind, krahasuar me 50 dhe 60 per qind qe ato u rriten ne menyre respektive ne vitet 1995 dhe 1994. Ne te vertete ky ngadalesim i rritjes se depozitave me afat, ashtu sic e kemi permendur edhe me siper, pasqyron levizjen nga depozita me afat drejt kompanive rentiere. Keshtu, perqindja e depozitave me afat kundrejt GDP-se regjistroi nje renie nga 12.3 per qind ne vitin 1995 ne 10.8 per qind ne vitin 1996. Ky zhvillim i dha nje pamje tjetër strukture te pasiveve te bankave tregtare nga pikepamja e maturitetit nga njera ane dhe beri me pak te percaktueshme aftesine e tyre per te dhene kredi ne terma afatgjate per investimet produktive private.

Duke pare grafikun 2.6. dhe ate 2.7. lehtesisht vihet re se struktura e depozitave ka pesuar ndryshime te ndjeshme. Zhvendosja e depozitave nga ato me afat ne llogari rrjedhese sigurisht ka ndikuar ne uljen e kosos se bankave tregtare, por njekohesisht aftesia e larte likujduese e depozitave pa afat i impononte bankave te ishin shume te kujdesshme ne perdorimin e ketyre burimeve ne instrumente afatgjate.


Depozitat ne valute kane qene pak a shume te qendrueshme dhe me tendence ne rritje gjate gjithë vitit. Ato u rriten me 69 per qind, ku peshen me te madhe e ka zene sektori privat me nje rritje te konsiderueshme ne tremujorin e fundit te vitit. Gjithsesi ne ndryshimet strukture te totalit te depozitave nuk mund te leme pa permendur spiralet e Lekut gjate vitit te kaluar, inflacionin si dhe faktore te ndyshem psikologjike.

Duke u ndalur ne perkatesine e depozitave duhet te theksojme se ndersa depozitat e sektorit privat ne Leke u rriten me rreth 64 per qind ato te sektorit publik u zvogluan me rreth 16 per qind. Kjo renie, edhe nje here, pasqyron perkeqesimin e pozicionit fiskal te qeverise.

Para se te ndalemi ne ndikimin e komponenteve te kerkeses per para, shkurtimisht do te ndalemi ne ecurine e nje treguesi te rendesishem ne ate te shpejtesise se qarkullimit te




Graf. 2.8. Struktura e depozitave me 31.12.'96



Graf. 2.9. Struktura e depozitave me 31.12.'95

¹⁵ Si asnjehere tjetër me pare ne periudhen tetor-nentor depozitat me afat u ulen me rreth 2 miliardë leke.



Graf. 2.10 Kontributi i aktivitetit në rritjen e M3
(në përqindje kundrejt vitit të kaluar)

parase. Përveç faktit që ky tregues tregon se sa here qarkullon një njësi monedhe në një periudhë kohe të caktuar kohe ai lidh shumë mirë prodhimin e përgjithshëm me ofertën e parase. Me konkretisht ky tregues do të shpjegonte se sa oferta e parase do të ishte e mjaftueshme për të gjeneruar një sasi të caktuar aktiviteti ekonomik. Duke u ndalur në ecurinë e këtij treguesi në tri vjetet e fundit përmbledhtazi do të thoshim se ai reflekton një tendencë të qartë në rënie që tregon se ndikimi i faktoreve rastësore (të paparashikueshëm) ka qenë i madh. Me hollësihtë pasi ka arritur pikën më të lartë në 3-mujorin e fundit të vitit 1994, shpejtesia e qarkullimit të parase në fund të vitit 1996, e matur me secilin agregat me vetë, vazhdimisht ka ardhur në rënie, duke shënuar nivelin më ulët të katër vjeteve të fundit. Kështu nga 3.9, 2.7 dhe 2.1 që ishte respektivisht për agregatin M1, M2 dhe M3 në fund të vitit 1995, në fund të vitit 1996 niveli i këtij treguesi për çdo agregat në mënyrë respektive si më sipër ishte 3.3, 2.5 dhe 1.9.


Pa u shkeputur nga shpejtesia e qarkullimit të parase, do të thonim se ndërsa rënia e normës së inflacionit dhe stabiliteti i kursit të këmbimit shpjegojnë rënie të saj në periudhën 1993-1995, për vitin 1996 rënia e metejshme e shpejtesisë së parase shpjegohet nga zhvillimet në tregun joformal të ekonomisë. Rritja e lartë e depozitave në të parë dhe pa afat, të gjeneruara nga aktiviteti i tregut joformal, shpjegon rënie të madhe në shpejtesinë e agregateve monetare M1, M2, dhe M3.

Duke përdorur identitetin e mëposhtëm ndërmjet aktiveve dhe pasiveve të sistemit bankar, lehtësisht mund të evidentohet kontributi i secilit ze të aktivitetit në përqindjen e rritjes së agregatit monetar M3:

$$M3 = NFA + NDCG + CE + OIN$$

ku NFA, NDCG, CE dhe OIN përfaqësojnë respektivisht mjetet valutore neto, kredinë neto për qeverinë, kredinë për ekonominë dhe aktivetë e tjera neto.

E parë nga identiteti i mësipërm vëhet re se kredia për qeverinë ka qenë zeri më i kontributit më të madh në rritjen e agregatit M3. Duhet theksuar se edhe ndryshimet në NFA kanë qenë një tjetër ze i rëndësishëm i aktivitetit që kanë kontribuar në rritjen e M3 vecanerisht në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1996. Këto konkluzione jo vetëm nënvizojnë rëndësinë e disiplinës financiare në kontrollin e ofertes së parase, por gjithashtu edhe ndërvaresinë midis politikës fiskale dhe monetare. Për më shumë ato theksojnë faktin se kontrolli i Bankës Qendrore mbi ofertën e parase (aftësia e saj për të kontrolluar inflacionin) varet në mënyrë themelore nga



Graf. 2.11. Përbërja e komponenteve të totalit të kredive në rritjen vjetore të M3
(ndikimi i totalit të kredive 100 %)

zhvillimet fiskale, ne kushtet e mungeses se ndermjetesave
financiare.

2.4 KREDIA PER EKONOMINE

Edhe gjate vitit 1996 kredia per ekonomine ju nenshtrua aplikimit te instrumentit **kufi kredie**. Duke pare realizimin e ketij kufiri si total per te gjithë vitin veme re se si sistem bankar kufiri i kredise u realizua ne masen 95.03 per qind. Duke u ndalur ne secilen banke me vete perqindjet e realizimit te kufirit vjetor te kreditit ndryshojne kryekeput nga njera-tjetra. Megjithate, e shohim te arsyeshme te permendim se me tejkalim paraqiten vetem dy banka: Banka e Kursimeve dhe Banka Italo-Shqiptare, te cilat respektivisht paraqiten me realizim ne masen 120 dhe 134 per qind.

Tabela 2.3. Kredia per Ekonomine

(Teprica e kredise; ne milione leke)

	1992	1993	1994	1995	1996
Kredi Afatshkurter	...	4075	4945	5826	6131
Sektori Shteteror	...	1322	1169	1525	1435
Sektori Privat	...	2753	3777	4300	4696
Nga e cila: e Pakthyer ne Afat	...	871	1934	2480	3176
Sektori Shteteror	...	188	249	198	340
Sektori Privat	...	683	1685	2282	2836
Kredi Afatgjate	...	2695	4212	5489	8215
Sektori Shteteror	...	1119	1250	1610	2495
Sektori Privat	...	1576	2962	3879	5720
Nga e cila: e Pakthyer ne Afat	...	57	518	961	1340
Sektori Shteteror	...	1	5	116	80
Sektori Privat	...	56	512	846	1260
Totali	...	6770	9158	11315	14346
Sektori Shteteror	...	2441	2419	3136	3930
Sektori Privat	...	4329	6739	8179	10416
Nga e cila: e Pakthyer ne Afat	...	929	2452	3441	4516
Sektori Shteteror	...	189	255	314	420
Sektori Privat	...	739	2198	3128	4096

Gjate vitit 1996 sistemi bankar kreditoi ekonomine per rreth 7.4 miliarde leke, nderkohe qe arketoi ne formen e shlyerjeve rreth 4.4 miliarde leke¹⁶. Ashtu si dhe ne vitet e fundit, sektori privat thithi me shume se gjysmen e kredise se dhene nga ana e sistemit bankar. Pervec faktit qe rreth 72 per qind e totalit te kredise ju akordua sektorit privat te ekonomise, do te theksonim se preferohet te kreditohet me shume ne terma afatshkurtra (76 per qind e totalit te kredise se dhene).

Dominon kredia per aktivitet tregtar, ndersa kredia afatgjate per privatet ne pjesen me te madhe eshte dhene per blerje banesash, per ndertim, blerje mjetesh mekanike ne bujqesi, etj. Ne sektorin shteteror kredia afatgjate eshte perqendruar per financimin e projekteve te tilla si ai i Bovilles, Telekomit, etj. si dhe ne ndertim, ndersa kredia afatshkurter eshte dhene me teper per

¹⁶ Raporti shlyerje-perdorim mbi bazen e te dhenave paraprake luhetet rreth nivelit 62 per qind.

industrine e rende e minierat. Ne kushtet aktuale te zhvillimit te ekonomise reale, drejtimi i kredise bankare ne aktivitetet prodhuese mbetet nje moment shume i rendesishem per zhvillimin e metejshem te vendit.

Krahasuar me fundin e vitit 1995 raporti i kredise se pakthyer me totalin e kredise gjithsej shenon nje rritje ne kufirin e 1.5 pike perqindjeje. Nje veshtrim i detajuar i te dhenave zbulon karakteristika te rendesishme te kredive te pakthyer ne afat; thuhet se 80 per qind e kredive te pakthyer ne afat e kane kaluar afatin prej 180 ditesh, cka praktikisht i shnderron ato ne kredi pa shprese arketimi ose me sakte mund te konsiderohen te humbura. Per me teper pesha specifike e sektorit publik ne totalin e kredive te pakthyer eshte vetem 8 per qind nderkohe qe ajo e sektorit privat dhe individeve mbetet ne nivelin 91 per qind.

Mangesite e bankave ne vleresimin e projekteve serioze, mentaliteti i sektorit privat per kredine e marre nga bankat shtetore, mangesite e theksuara ne kolateralizimin e kredive, brishtesia e vete sektorit privat, etj. numerohen si faktore te qenesishem ne rritjen eksesive te kredise se pakthyer ne afat si dhe ne frenimin e kreditimit te metejshem te ketij sektori.

2.5 FINANCIMI I DEFICITIT BUXHETOR

2.5.1 ZHVILLIMET FISKALE GJATE VITIT 1996

Konsolidimi fiskal ka qene nje komponent tjetër kyc i programit të stabilizimit makroekonomik në Shqipëri që në të njëjtën kohë ka kontribuar fuqimisht në arritjen e një rritjeje të fuqishme dhe stabilitetit të cmimeve në dy vjetet e parë të periudhës së tranzicionit. Shenjat e para për një ekspansion të deficitit buxhetor u shfaqën që në fundin e vitit 1995, kur u evidentua një rritje shumë e lehtë e deficitit buxhetor si përqindje ndaj GDP-se.

Perpjekjet për konsolidim fiskal u vunë në pikëpyetje gjatë vitit 1996 kur u regjistrua një deficit buxhetor në masën 11.2 përqind ndaj GDP-se nga 8.5 përqind që ishte në vitin e mëparshëm. Krahasuar me vitin e mëparshëm totali i të ardhurave u rrit me rreth 12 përqind ndërkohë që totali i shpenzimeve njohu një rritje rreth 2 here më të madhe (25 përqind). Këto zhvillime bene që në terma nominale deficiti fiskal të ishte rreth 57 përqind më i lartë se ai i vitit të kaluar.


Duke u ndalur në zhvillimet e shpenzimeve, shkurtimisht do të eidentonim:

- Shpenzimet korrente në përqindje ndaj GDP-se u rriten me rreth 11 përqind krahasuar me vitin e mëparshëm. Megjithatë krahasuar me vendet e tjera në tranzicion përqindja e këtyre shpenzimeve ndaj GDP-se është rreth 10 deri në 15 pike përqindjeje më e ulët.
- Shpenzimet për investime llogarisin vetëm 4.6 përqind të GDP-se nga 6.5 përqind në vitin 1995. Kjo rënie pasqyrohet edhe në terma nominale me rreth 2 miliardë Leke.
- Shpenzimet për paga zënë 25 përqind të totalit të shpenzimeve duke përbërë dhe komponentin më të madh të tyre. Në bashkë me shpenzimet për sigurimet shoqërore, zënë rreth 46 përqind të totalit të shpenzimeve.
- Krahasuar me vitin 1995 pesha specifike e shpenzimeve për investime është ulur ndjeshëm me rreth 31 përqind, ndërkohë që pesha specifike e pagesave për interesa është rritur ndjeshëm me 39 përqind.


Nga ana tjetër mbledhja e të ardhurave fiskale gjatë vitit 1996 ishte në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se ajo cka ishte planifikuar. Megjithatë rritjen e të ardhurave si përqindje e GDP-se nga taksa mbi fitimin, dogana dhe nga prezantimi i taksës mbi vlerën e shtuar në korrik 1996 perseri nuk u bë e mundur shmangia e zhvillimeve jo të favorshme në të ardhurat fiskale.

Duke u ndalur në të ardhurat e realizuara gjatë vitit 1996 do të theksonim:


- Krahasuar me vitin 1995 të ardhurat nga taksat rënë me rreth 1 përqind, rënie e shkaktuar kryesisht nga realizimi më i ulët i të ardhurave nga akciza, taksa e qarkullimit dhe taksa kombëtare.




Graf. 2.12. Te ardhurat e Buxhetit (ne % te GDP-se)



Graf. 2.13. Shpenzimet e Buxhetit (ne % te GDP-se)



Graf. 2.14. Deficiti Buxhetor (ne % te GDP-se)



Graf. 2.15. Investimet Buxhetore (ne % te GDP-se)

- Renien me te madhe e regjistroi taksa e akcizes e cila ne terma nominale shenoi renie ne masen 52 per qind. Edhe taksa e qarkullimit njohu nje mase te madhe renieje. Krahasuar me vitin 1995 te ardhurat nominale nga kjo takse ishin 33 per qind me te ulta. Mosderdhja e detyrimeve per taksen e akcizes nga nje numer i madh ndermarrjesh shteterore, perjashtimet e medha ne bazen e takses se qarkullimit, si dhe mangesi te mundshme ne planifikim, jane faktoret kryesore ne performancen negative te ketij grupi taksash.
- Nje renie tjeter e dukshme i takon takses kombetare dhe asaj mbi pasurine. Gjate vitit 1996, renia e ketyre dy zerave si perqindje e GDP-se ishte perkatesisht 47 dhe 50 per qind.
- Edhe te ardhurat nga jotaksat, ne terma nominale gjate vitit 1996, njohen nje renie te konsiderueshme ne masen 20 per qind. Kjo renie reflektohet ne peshen specifike te tyre ndaj totalit te te ardhurave e cila nga 22 per qind ne vitin 1995, ne fund te vitit 1996 shenonte vetem 16 per qind.

2.5.2 FINANCIMI I DEFICITIT BUXHETOR

Gjithmone sa here na kerkoet per te vleresuar efektet e nje deficiti prezent ne nje moment te dhene, duhet te ndalemi ne magnituden dhe menyren se si ai eshte financuar. Ne pergjithesi deficitet buxhetore mund te financohen nepermjet burimeve te brendeshme (bankare ose jobankare) dhe atyre te jashtme. Ne cdo rast perdorimi eksesiv i njerit burim ka efektet e tij negative duke u shnderruar ne nje burim potencial per lekundjen e objektivave makroekonomike. Keshtu per shembull, procesi i krijimit te parase per te financuar deficitin shpesh con ne inflacion, nderkohe qe te njejtat konsequenca rrjedhin dhe ne rastin e huamarrjes nga bankat tregtare ne kushtet kur burimet e tjera te brendeshme jane te kufizuara. Financimi nepermjet huamarrjes se pakufizuar nga sektori jobankar do te kufizonte aftesine e ketij sektori per te investuar dhe ne kete menyre do te cenohej rritja potenciale e ekonomise. Ne fund, ne kushtet e nje financimi eksesiv me burime te jashtme, do te conte ne perkeqesim te llogarise korrente dhe ne vleresim te kursit te kembimit ne terma reale gje qe perben nje rrezik potencial per krize ne bilancin e pagesave. Kjo do te conte ne nje shterim te rezervave valutore dhe do te shoqerohej me nje krize ne borxhin e jashtem.

Historikisht deri ne vitin 1993 burimet e brendeshme te financimit ishin te unifikuara vetem me kredine direkte nga Banka Qendrore. Duke filluar qe nga viti 1994 pervec ketij burimi gjithnje e me shume filloi te perdorej shitja e borxhit publikut nepermjet bonove te thesarit maturimi i te cilave luhatet nga tre muaj deri ne nje vit. Mbas nje pjesemarrjeje modeste ne vitin 1994, ne vitin 1995 per here te pare deficiti buxhetor ne masen 66 per qind financohet me bono thesari, nderkohe qe ky financim ne vitin paraardhes perbente vetem 7 per qind te deficitit buxhetor te financuar me burime te brendeshme. Nderkohe gjate vitit 1996 mbulimi i deficitit buxhetor me bono thesari arriti nje shifer akoma me te larte duke arritur ne 83 per qind te totalit te deficitit te financuar me burime te brendshme.

Megjithë pjesëmarrjen e lartë të bonove të thesarit në procesin e financimit të deficitit buxhetor duhet theksuar se, pjesa dërrmuese e bonove është blerë nga bankat e nivelit të dytë e me konkretisht nga bankat me kapital shtetëror. Po të shihet struktura e financimit të deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar¹⁷ vihet re se ndërsa bankat me kapital shtetëror kanë qenë aktive në tregun e bonove të thesarit, bankat e tjera kanë qenë shumë indiferente.

Në fund të vitit 1996 zoterimet në bono thesari nga këto banka numëronin shifrën 42 miliardë leke nga 12 miliardë që ato ishin në vitin 1995. Kjo pjesëmarrje e lartë e tyre është diktuar në masë të madhe nga ekzistenca e rezervave të lira, nga aplikimi i kufirit të kredive për ekonominë, nga mungesa e plotë e një tregu të mirëfilltë kapitalësh me mundësira të mëdha investimi, etj. Është interesant fakti se pjesëmarrja e institucioneve të tjera financiare jobankare dhe e publikut është në përgjithësi shumë e ulët, për të mos thënë e papërfillshme. Kjo tregon se duhen marrë masa urgjente për krijimin e një tregu sekondar dhe me pakicë, likuid dhe efektiv.

Është e kuptueshme që përfshirja e sektorit jobankar në tregun e bonove të thesarit tashmë është një domosdoshmëri. Gjendja e rënduar e deficitit buxhetor dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme për financimin e tij kanë shkaktuar një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimet monetare. Në periudha të ndryshme kohore, ndër të tjera ato krijuan mjaft probleme likuiditeti për bankat tregtare edhe në sistemin bankar, duke ndikuar negativisht në tregun ndërbankar të parase.

¹⁷ Në kushtet e mungesës së kapitaleve të huaja dhe të mundësive që sektori privat të marrë hua me shumë nga jashtë, borxhi publik ka një efekt me të madh makroekonomik, prandaj duhet punuar me tej që të mobilizohen sa më shumë burimet e brendshme të mundshme të investimit në këto huamarrje si një alternativë tjetër investimesh.

3. BILANCI I PAGESAVE


3.1 ZHVILLIMET NE BILANCIN E PAGESAVE

Qe nga viti 1993, me adoptimin e programit te stabilizimit, deficitit tregtar dhe ai korrent (pa transferta) te shprehur si raport ndaj GDP kane shfaqur nje tendence ne renie. Fatkeqesisht keto tendenca favorizuese nuk vazhduan edhe me tej gjate vitit 1996. Si deficitit tregtar dhe ai korrent u rriten ndjeshem si pasoje e rritjes se kerkeses se brendeshme te nxitur nga rritja ekonomike, influkset e larta te kapitalit, transfertave korrente dhe shkrirja e kursimeve te sektorit shtepiak. Ekzistenca e tregut te fajdese prishi ekuilibrin ekonomik te kursimeve dhe investimeve, te vetmin mekanizem rregullues qe disponon qeveria ne kushtet e nje kursi fleksibel kembimi. Interesat e larta terhoqen te gjitha kursimet e popullates dhe ndalen rritjen e kursimeve te reja duke e orientuar cdo te ardhur shtese nga investimet dhe konsumi. Turnoveri i transakcioneve korrente si perqindje ndaj GDP tregon per hapjen e madhe te ekonomise shqiptare dhe varesine e saj nga politika fiskale liberale e ndjekur gjate vitit 1996, kjo e fundit nxiti me tej rritjen e deficitit korrent.


Llogaria financiare nepermjet kredive dhe investimeve te huaja ka siguruar financimin per deficitin korrent, por pa mundur ta financoje ate plotesisht. Te gjitha keto zhvillime u shoqeruan nga rritja e rezervave monetare me 47 milione dollare amerikane.

Llogaria Korrente ne fund te vitit u mbyll me nje deficit prej 122.4 milione dollare amerikane dhe perfaqeson shifren me e larte te regjistruar qe nga viti 1992. Rritja e deficitit te mallrave dhe sherbimeve me 40.6 per qind kundrejt 1995 qendron si shkak kryesor per rritjen e deficitit korrent. Eksportet u rriten shume pak 11.7 per qind, dhe ne fund te vitit mbulonin vetem 25 per qind te importeve nga 30 per qind ne 1995, nderkohe qe rritja e transfertave korrente dhe e te ardhurave sebashku per 109.7 milione dollare amerikane kundrejt 1995 nuk ishin te mjaftueshme per te perballuar nevojen per shpenzime korrente ne zerat e tjere (import mallrash e sherbimesh). Vleresimi i kursit te kembimit gjate gjithë vitit shoqeroi rritjen e deficitit korrent nga 22.7 milione dollare amerikane ne tremujorin e pare, ne 39.6 ne ate te katert.


Per te katertin vit radhazi Bilanci Tregtar vazhdon te thellohet ne deficit. Ne fund te 1996 ky defici vleresohet ne 692 milione dollare, ose 45.6 per qind me i larte se ai i nje viti me pare duke regjistruar keshtu rritjen me te larte nga viti 1992. Shkak per thellimin e deficitit tregtar mbetet rritja e importeve, qe kete vit ndryshe nga ato paraardhese regjistruan ritme rritjeje disa here me te larte se ato te eksporteve. Respektivisht importet u rriten me 35.4 per qind dhe eksportet me 11.6 per qind. I shprehur ne perqindje ndaj GDP volumi i tregtise se jashtme mbeti i pandryshuar rreth shifrave 40 per qind. Ky raport kaq i larte i tregtise se jashtme ndaj GDP tregon edhe nje here per hapjen e



Graf. 3.1. Llogaritë e Bilancit të Pagesave (ne milione USD)



Graf. 3.2. Rezervat e Autoritetit Monetar (ne milione USD)



Graf. 3.3. Bilanci tregtar ne vite
(Ne miliona USD)

madhe te ekonomise shqiptare.

Perkeqesimi i deficitit tregtar u shkaktua kryesisht nga aktiviteti me vendet e Evropes Perendimore. Nderkohe qe ne vendet e tjera evropianolindore Gjermania okupon peshen kryesore te aktivitetit tregtar, per Shqiperine ajo radhitet partneri i trete kryesor mbas Italise dhe Greqise.

Viti 1996 shenoi per importet nje nivel rekord prej 920.5 milone dollare ose 35.4 per qind me te larte se viti paraardhes nga te cilat rreth 30 per qind kane kaluar nga sistemi bankar. Megjithe rritjen e madhe te importeve raporti i tyre ndaj GDP mbeti i pandryshuar rreth shifrave 32 per qind, dhe perfaqeson 79.6 per qind te shpenzimeve korrente per vitin 1996 nga 74.8 vitin e kaluar. Importi eshte karakterizuar nga nje tendence ne rritje pergjate gjithë vitit duke arritur nivelin me te larte ne tremujorin e fundit, i nxitur nga influkse te medha valute dhe ndoshta nga forcimi i Lekut. Rritja e fuqishme e importeve reflekton kryesisht nje politike liberale konsumi dhe investime te larta ne vend. Rritja e vellimit te pergjithshem te importit ka qene pasoje e rritjes se importeve ne te gjithë zerat e grupmallrave kryesore. Vazhdoi edhe kete vit renia e importeve ndihma me 36.7 per qind kundrejt vitit paraardhes, ne 1995 keto importe rane me 14.8 per qind. E njejta situatë paraqitet per mallrat e financuara nga emigrantet, qe megjithate zene nje peshe fare te paperfillshme (kane rene nga 1.7 milione dollare ne 1 milione dollare). Rritja e vellimit te importeve nuk ka sjelle ndryshime te dukshme ne strukturen e mbulimit te importeve mes sektorit privat dhe atij shteteror, kete vit sektori privat ka zene vetem 2 per qind me teper se viti i kaluar per nje total viti prej 82 perqindesh. Me perjashtim te importeve ne Lende djegese te cilat per vitin 1996 rane me 24 per qind krahasuar me vitin paraardhes, te gjithë zerat kryesore te importeve shenuan rritje.

Grupmali ushqime, pije dhe duhan vazhdon te zere peshen kryesore ne totalin e importeve (rreth 35 per qind) dhe krahasuar me vitin paraardhes keto importe jane rritur ndjeshem me 98 per qind. Brenda ketij grupmali peshen kryesore e zene importet e Produkteve vegjetale me 50 per qind te importeve te ketij grupmali. Importet ne drithra dhe fruta kane qene importet kryesore te produkteve vegjetale per kete vit me perkatesisht 83 per qind dhe 10 per qind peshe ne totalin e importuar. Importet e mishit, qe kete vit zune 9.5 per qind te totalit te importuar per grupmallin ushqime, pije dhe duhan, u rriten me 60.8 per qind ndaj vitit paraardhes.

Importet ne mallra te perpunuara jane ndikuar deri ne nje fare mase nga rritja e eksporteve, pasi keto te fundit permbajne nje pjese te konsiderueshme te ketyre importeve (mallra per perpunim aktiv). Importet per perpunim aktiv perfaqesohen kryesisht nga tekstile dhe artikuj tekstile dhe kepuce, te cilat zene rreth 73 per qind te totalit te ketyre importeve. Gjate vitit 1996 importet e mallrave te perpunuara kane shfaqur tendence ne rritje, dhe krahasuar me vitin paraardhes keto importe shenuan nje nivel 60 per qind me te larte.

Viti 1996 shenoi nje rritje te konsiderueshme ne importet e grupmallit makineri, pajisje dhe mjete transporti me 64.3 per qind kundrejt vitit te kaluar, duke ruajtur peshen prej 22.3 per qind ne totalin e importeve. Brenda ketij grupmalli jane importet ne makineri, pajisje mekanike dhe elektrike ato qe zune peshen me te madhe te importuar (72.6 per qind), pjesa tjeter (27.4 per qind) i takon importeve ne mjete transporti. Importet ne automjete, si nje ze i vecante i grupit mjete transporti, kete vit u rriten me 33.7 per qind. Importet ne mallrat elektro-shtepiake kete vit okupuan 4.7 per qind te importeve ne makineri, pajisje mekanike dhe elektrike dhe pesuan nje renie prej 80 per qind krahasuar me vitin e kaluar.


Megjithë rritjen e madhe te importeve, Italia vazhdon te zere te njejtin vellim ne totalin e tyre, si nje vit me pare. Importet nga Italia, vec preferences se konsumatoreve per mallra italiane, kryesisht produkte vegjetale, tekstile dhe artikuj tekstile, kepuce reflektojne dhe investimet kapitale italiane ne Shqiperi, nepermjet 66 per qind importe ne makineri dhe pajisje mekanike dhe elektrike dhe rreth 80 per qind ne mallra per perpunim aktiv.

Viti 1996 shenoi nje renie prej 6 pike perqindjeje ne vellimin e importeve greke ndaj totalit. Importet kryesore me Greqine per kete vit kane qene; -importe ne kafshe te gjalla, produkte me origjine kafshore ku mbizoterojne importet e mishit dhe te peshkut, -importet ne produkte vegjetale kryesisht importe ne fruta, kafe, caj dhe erezë, -importe ne lende djegese minerale dhe importe ne artikujt e veshjes.

Aktiviteti tregtar me vendet e rajonit zhvillohet kryesisht me Turqine, Bullgarine dhe Maqedonine. Kete vit importet nga Bullgaria shenuan nje nivel 4 pike perqindjeje me te ulet se nje vit me pare.

Eksporti tregtar shenoi nje nivel 228.6 milione dollare ose nje rritje prej 11.6 per qind me te larte se viti paraardhes, nga 44.8 nje vit me pare. Rritja e eksporteve eshte teresisht pasoje e rritjes se eksportit te energjise elektrike, nderkohe qe eksportet tradicionale ruajten nivelin e nje viti me pare. Eksportet jane ndikuar me teper nga zhvillimi i kerkeses se jashtme sesa nga oferta. Renia ekonomike ne vendet e Evropes perendimore ka rezultuar ne uljen e kerkeses per importe nga ekonomite lindore, kryesisht per eksportet e lendeve te para, duke ndikuar cmimet e ketyre grupmallrave ne tregjet boterore. Ne vitin 1996 sektori privat ka eksportuar 74 per qind te totalit te eksporteve ose 15 pike perqindjeje me shume kundrejt vitit te kaluar. Kjo rritje reflekton jo vetem ekspansionin e sektorit privat por edhe renien e eksporteve shteterore me 18 per qind kundrejt vitit te kaluar per pasoje te koniukturave te disfavorshme te cmimeve. Eksportet me te larta u regjistruan ne tremujorin e pare te vitit, pasuar me nje tendence ne renie per tremujoret e dyte dhe te trete per t'u rritur lehte ne te katertin, si rrjedhim gjashtemujori i dyte regjistroi nje eksport 11 per qind me te ulet se periudha paraardhese. Rol te rendesishem ne eksporte vazhdojne te luajne riekportet nga perpunimi aktiv me 47 per qind te totalit te eksporteve kundrejt 45.1 per qind ne vitin 1995.

Tabela 3.1 Bilanci i Pagesave ne vite



Graf. 3.4. Llogaria Korrente
 Llogaria Korrente
 Bilanci Tregtar
 Bilanci i Sherbimeve
 Bilanci i te Ardhurave
 Transfertat korrente
 (Milliona USD, fluks 12-mujor)

(Ne milione USD)

	1992	1993	1994	1995	1996
Llogaria Korrente	-50.8	14.7	-42.7	-14.6	-122.5
Tregtia: Eksportet, fob	70.0	111.7	141.3	204.8	228.8
Tregtia: Importet, fob	-540.5	-601.6	-601.0	-679.8	-922.5
Bilanci Tregtar	-470.5	-489.9	-459.7	-475.0	-691.7
Sherbimet: Kredi	20.3	77.5	83.1	97.0	128.9
Sherbimet: Debi	-89.2	-162.0	-171.5	-156.3	-188.9
Te Ardhurat: Kredi	2.6	64.9	55.6	70.8	83.5
Te Ardhurat: Debi	-37.7	-31.0	-41.5	-28.5	-12.0
Transfertat Private	150.0	274.8	374.1	348.9	476.0
Transfertat Shtetore, etj.	373.7	280.4	117.2	128.5	81.8
Investimet Direkte	20.0	58.0	52.9	70.0	90.1
Investimet e Portofolit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferime te tjera te Kapitalit	10.7	52.1	11.6	-93.1	-30.9
Sektori Rezident Shtetor	55.0	106.9	119.0	-24.6	67.2
Bankat Tregtare	-59.6	-43.5	-80.2	-56.9	-109.5
Sektoret e tjere	15.3	-11.4	-22.3	-11.6	11.3
Gabime dhe Harresa (neto)	44.8	-9.9	33.0	57.1	110.2
Bilanci i Pergjithshem	24.7	114.9	54.8	30.6	47.0
Rezervat & tregues te lidhur me to					
Rezervat Valutore	-24.7	-114.9	-54.8	-30.6	-47.0
Perdorimi i kredive te FMN	13.9	16.6	22.2	11.1	0.0

Viti u mbyll pa ndonje ndryshim ne strukturen e eksporteve tradicionale, vazhdojne te dominojne eksportet ne mallra te perpunuara kryesisht tekstile dhe kepuce, te cilat kete vit zune rreth 63 per qind te totalit, eksportet ne produktet minerale dhe metalet dhe prodhimet e tyre te cilat perfaqesojne 19 per qind te totalit, si dhe eksportet per grupmallin ushqime, pije dhe duhan qe kete vit zune rreth 16 per qind te totalit.

Eksportet e mallrave te perpunuara qe zune rreth 63 per qind te totalit te eksportit, dhe per kete vit shenuan nje nivel 36 per qind me te larte krahasuar me nje vit me pare. Artikujt tekstile dhe kepuce mbajne peshen kryesore te ketyre eksporteve, per kete vit ato zune rreth 70 per qind te totalit. Pjesa me e madhe e eksporteve te mallrave te perpunuara rreth 73 per qind eshte rieksperti nga perpunimi aktiv (ose 47 per qind e totalit te eksportit) duke pasqyruar efektin "Feed back" te importeve te larta te mallrave per perpunimin aktiv. Pjesa tjeter, del si eksport i mallrave te perpunuara vendase.

Eksportet ne grupmallrat produkte minerale dhe metalet dhe prodhimet e tyre perfaqesohen nga industria e rromit dhe ajo e bakrit. Eksportet e kesaj industrie ndikohen ndjeshem nga faktori cmim i cili diktohet nga tregjet boterore, dhe qe per vitin 1996 ka patur nje renie kundrejt cmimit te vitit 1995.

Viti 1996 shenoi nje nivel 55.6 per qind me pak ne vlere per eksportet e bakrit, krahasuar me vitin e kaluar. Kjo renie ne

vleren e eksportit te kesaj dege eshte teresisht rrjedhoje e renies se cmimit ne tregun boteror 30 per qind kundrejt vitit '95. Rritja e vogel e sasise se eksportuar me 4.3 per qind kundrejt vitit paraardhes nuk e mbuloi renien e theksuar te cmimit, duke shkaktuar renie ne vleren e eksportit te kesaj dege. Brenda kesaj industrie bakri katodik ze 93 per qind te totalit te eksportuar, pjesa tjeter i takon eksporteve ne skorje bakri dhe sulfat bakri qe kane ruajtur nivelin e nje viti me pare.

Eksportet e industrise se kromit edhe per kete vit ruajten te njejtin nivel me vitin paraardhes. Zhvillimi me negativ per kete industri ka qene renia e cmimit te tregtimit me 16 per qind. Rritja e sasise se shitur beri qe eksporti i kesaj dege te ruaje nivelin e nje viti me pare. Peshen kryesore ne eksportet e kesaj dege e ze ferrokromi me 74 per qind, qe per kete vit ruajti te njejten vlere eksporti me 1995. Kjo qendrushmeri eshte rrjedhoje e kombinimit te rritjes se prodhimit me 54 per qind dhe uljes se cmimit me 35 per qind. Koncentrati i kromit me rreth 10 per qind te totalit te eksporteve te kesaj dege, ze vendin e dyte per nga volumi.

Eksportet per grupmallin ushqim, pije dhe duhan shenuan nje rritje prej 43 per qind ndaj vitit paraardhes. Brenda ketij grupmalli te ardhurat nga eksporti i agrikultures pesuan renie me rreth 7 per qind. Eksportet ne grupmallin e ushqimeve rane me 6.7 per qind kundrejt vitit te kaluar. Brenda ketij grupmalli peshen me te madhe e zene eksportet e peshkut me 67 per qind (nga 16 per qind ne 1995), kundrejt vitit te kaluar keto eksporte jane rritur afersisht 3 here. Eksportet e grupmallit Pije dhe duhan jane rritur per 2.6 here, rritje kjo qe ka ardhur si pasoje e rritjes ne eksportet e duhanit me 3.8 here kundrejt nje viti me pare.

Eksportet ne bime mjeksore eterovajore jane rritur gjithashtu me 27 per qind, por keto eksporte nuk kane peshe te konsiderueshme ne totalin e eksportit.

Eksportet vazhdojne te mbeten te orientuara drejt Italise dhe Greqise me perkatesisht 58 dhe 13 per qind te totalit.

Bilanci i sherbimeve per te katerten here u mbyll me shifra negative 60 milione dollare amerikane. Duke bere nje krahasim me vitin 1995 (59,3 milion dollare amerikane) shohim se ai eshte rritur afersisht 1.2 per qind.

Deficiti i llogarise se sherbimeve ka qene rrjedhim i rritjes se deficitit te sherbimeve te transportit dhe sigurimit perkatesisht me 23 dhe 35.5 per qind. Perkeqesimi i deficitit ne keto dy zera eshte shkaktuar per rrjedhoje e rritjes se shpenzimeve te induktuara nga rritja e importeve ne mallra. Llogaria sherbime transporti shkaktoi pjesen derrmuese te deficitit te sherbimeve (rreth 87 per qind te tij). Deficiti i larte i krijuar nga sherbimet e transportit te mallrave u ul lehte nga sherbimet e transportit te pasagjereve, qe pas tre vjeteve radhazi me deficit, ne fund te vitit 1996 regjistroi nje suficit prej 3,3 milione dollare amerikane. Baza e informacionit per sherbimet e pasagjereve mbetet sistemit bankar.

Te ardhurat neto nga turizmi, qe eshte aktiviteti kryesor arketues i sherbimeve, vazhdojne te rriten qe nga viti 1992 kryesisht nga rritja e arketimeve (18.1 per qind kundrejt vitit 1995). Rritja e te ardhurave ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes se numrit te vizitoreve afersisht 15 per qind me shume krahasuar me nje vit me pare. Kjo rritje eshte orientuar ne favor te turizmit te organizuar privat dhe atij familjar. Shume shpejt u rriten edhe shpenzimet e bera nga rezidentet per turizem jashte shtetit.

Nje permiresim ne deficitin e bilancit te sherbimeve solli dhe ulja prej 9.8 milione dollare amerikane ne krahasim me vitin 1995 ne deficitin e llogarise sherbime te tjera. Per efekt te shkurtimit te ndihmave ne asistence teknike shpenzimet per kete ze rane me rreth 10 per qind, nderkohe qe sherbimet financiare u paraqiten me nje te ardhur neto 2,8 milione dollare amerikane me shume se ne vitin 1995. Zerat e tjere te llogarise sherbime paraqiten pak a shume ne te njejtin nivel si vitin e kaluar.

Te ardhurat u paraqiten me zhvillime pozitive pergjate vitit 1996. Te ardhurat neto prej tyre u rriten me rreth 70 per qind kundrejt vitit te kaluar, per dy arsye kryesore:

- a. rritja e te ardhurave nga punonjesit sezonale te nxitur nga tregu i fajdese.
- b. pagesat e interesave te borxhit rane paralelisht me reduktimin e borxhit te jashtem neto pas marreveshjeve te shtatorit 1995.

Keto dy fenomene u shoqeruan, gjithashtu, nga nje rritje e lehte e interesave te pagueshme per depozitat e rezidenteve jashte.

Transfertat korrente mbeten burimi i vetem kryesor i financimit per llogarine korrente. Me nje suficit prej 558 ose 17 per qind me te larte nga viti 1995, transfertat mbuluan 82 per qind te deficitit te rregjistruar ne transaksionet e tjera korrente. Rritja e suficitit eshte rrjedhoje direkte e rritjes se transfertave nga jashte-brenda ne sektorin privat (refugjatet) dhe shume pak zvogelimi i transfertave private ne kah te kundert, nderkohe qe transfertat shteterore kete vit u paraqiten me nje suficit 36 per qind me te ulet. Kryesisht per pasoje te zvogelimit te ndihmave ne kesh dhe asistence teknike perkatesisht 40 dhe 38 per qind, ndihmat ne mallra dhe te tjera rane, gjithashtu.

Ndryshe nga sa pritej te ardhurat nga refugjatet gjate vitit 1996 jo vetem qe u rriten por paten nje bum prej afro 500 milione dollare amerikane ose 30 per qind me te larte se nje vit me pare. Keto transfertat perfaqesojne rreth 17.4 per qind te GDP sikunder edhe ne 1995. Influkset e larta te valutes qe perbejne shifren me te larte te rregjistruar ne pese vjetet e fundit, mendohet te jene inkurajuar kryesisht nga interesat e larta te ofruara ne tregun joformal te fajdese. Shperndarja ne kohe e influkseve te valutes e mbeshtet kete supozim, hyrjet jane vecanerisht te larta ne fund te tremujorit te trete dhe ne te katertin, periudhe qe i korrespondon rritjes se interesave te ofruara nga tregu i fajdeve. Meqenese mundesite optimale te investimit per kete periudhe ofroreshin per mjetet financiare te brendeshme (Lekun), influksi i valutes u shfaq ne treg si oferte duke ndikuar ne vleresimin e Lekut shqiptar ne

fund te tremujorit te trete e gjate dy muajve te pare te tremujorit te katert. Megjithese shume te larta dhe mbuluan nje pjese te mire te deficitit te akumuluar nga transaksionet e tjera korrente, rreth 82 per qind, ato nepermjet forcimit te Lekut dhe krijimit te burimeve financuese u bene shkak per inkurajimin e importit dhe rritjen e deficitit tregtar.

Llogaria Kapitale dhe Financiare u mbyll me nje influks neto kapitali prej afro 58 milione dollare (ne ndryshim nga 1995 qe u mbyll me nje deficit prej 12 milione dollare), pasoje direkte e influkseve te larta ne kapitalet afatgjata (investime te huaja direkte dhe influkse neto te larta nepermjet borxhit te jashtem) keshtu totali i detyrimeve ndaj botes rezulton me nje shifer 191 milione dollare. Rreth 50 per qind e ketyre detyrimeve u balancuan nga rritja e fuqishme e mjeteve te mbajtura nga rezidentet (kryesisht ne gjysmen e dyte te vitit) me 92 milione dollare. Ky suficit ka mbuluar ne njefare mase deficitin e transaksioneve korrente 48 per qind.

Ashtu si ne vitet parardhes edhe ne vitin 1996 investimet e huaja luajten nje rol dominant ne levizjet e kapitalit dhe totali i influkseve ne investime direkte u rrit kundrejt vitit 1995 me 20 milione dollare. Keto investime kane hyre kryesisht nga Italia e Greqia e kane pasur karakterin e investimeve direkte ne bizneset ndertim, infrastrukture, transport dhe industri e lehte.

Nje arsye tjeter eshte vershimi i kapitaleve ne formen e disbursimeve te kredive e huaja prej 82 milione dollare. Gjithashtu, ne saje te ligjit qe ndalon transferimin e kapitaleve nga Shqiperia nuk ka ende investime te shqiptareve jashte.

Borxhi i jashtem u rrit me nje shifer prej 66 milione dollare amerikane. Huamarrjet bruto nga jashte vazhdojne te zvogelohen per te katertin vit rradhazi dhe llogariten ne 86 milione dollare amerikane nga 83 milione dollare amerikane ne '95. Shifra bruto perfaqeson disbursimet nga 46 linja krediti afatgjata 10 prej te cilave te celura ne vitin 96. Ne pjesen me te madhe te tyre disbursimet e kredive te huaja jane drejtuar ne investime infrastrukture, asistence teknike dhe arsim. I gjithë borxhi eshte disbursuar ne monedha te forta dollare amerikane, SDR dhe DEM kryesisht nga Banka Boterore, Gjermania, Italia qe se bashku okupojne 60 per qind te totalit te disbursimeve.

Pas shlyerjes se detyrimeve te maturuara (ripagesave) per nje total prej 16 milione dollare amerikane, stoku i detyrimeve qe Shqiperia ka ndaj vendeve te huaja me 31 dhjetor 1996 rezulton ne 380 milione dollare amerikane, qe perfaqeson 13.2 per qind te GDP ne krahasim me 10 per qind te vitit te kaluar. Ky detyrim ne pjesen me te madhe te tij me rreth 65 per qind eshte borxh i Qeverise se Pergjithshme, 21 per qind eshte borxh i Autoriteteve Monetare dhe pjesa tjeter eshte detyrim i sistemit bankar dhe sektoreve te tjere te ekonomise.

Rritja e mjeteve rezidenteve u shoqerua nga nje pakesim i depozitave te jorezidenteve me bankat shqiptare duke i ulur detyrimet afatshkurtra per 2.4 milione dollare amerikane. Depozitat

e jorezidenteve ne bankat shqiptare u ulen me 2.4 milione dollare ne 1996 nga 3.3 milione dollare qe u rriten ne 1995. Gjate tremujorit te pare dhe te dyte keto depozita kane rene respektivisht me 1.1 dhe 3.2 milione dollare. Gjate tremujorit te trete kemi nje rritje te depozitave me 1.3 milione dollare. Gjate tremujorit te katert kemi nje renie te ketyre depozitave prej 1.6 milione dollare kryesisht nga bankat shteterore.

Kredia tregtare ne fund te vitit 1996 u vleresua me nje rritje prej afro 25.8 milione dollare. Gjate nente muajve te pare te vitit kjo rritje nuk ka qene shume e ndjeshme pothuajse 6 milione dollare, ndersa vetem ne tremujorin e katert rritja ka qene shume e madhe dhe ka kapur shifren 20 milione dollare, rritje kjo qe ka ardhur si pasoje e rritjes se importeve.

Mjetet e mbajtura nga rezidentet kryesisht depozita e llogari rrjedhese te sistemit bankar me bankat jorezidente edhe mjete valutore ne kesh te sistemit bankar dhe te publikut per kete vit ishte 52 per qind me e larte se nje vit me pare dhe perbente pjesen derrmuese te outflukseve te valutes. Nderhyrja e Bankes se Shqiperise ne tremujorin e pare ne tregun e kembimeve valutore zvogeloi depozitat e sistemit bankar per 19 milione dollare gje qe solli renien e mjeteve per gjashtemujorin e pare. Gjashtemujori i dyte paraqitet me nje rritje te pazakonte per mjetet, perkatesisht tremujori i trete dhe i katert me 45 dhe 53 milione dollare. Kjo rritje e madhe e mjeteve ka ardhur nga rritja e depozitave dhe jo nga llogarite rrjedhese.

Mjetet valutore ne cash ne sistemin bankar u rriten me 13 milione dollare ne 1996 nga 7 milione dollare ne 1995. Mbas renies me 7 milione dollare ne gjashtemujorin e pare, periudha pasardhese u shoqerua me nje rritje prej 20 milione dollare, ne te njejtat banka si per depozitat. Sipas vleresimeve te Bankes se Shqiperise kursimet ne mjete te huaja te mbajtura nga sektori shtepiak kane ndjekur nje tendence krejt tjeter. Ato jane rritur lehte ne gjashtemujorin e pare dhe pak ose aspak ne gjashtemujorin e dyte.

Gjate ketij viti rezervat e mjeteve valutore u rriten 47 milione dollare amerikane. Niveli i rezervave ne fund te periudhes do te mjaftonte per te perballuar 15 jave importe.

3.2 ZHVILLIMET NE REZERVEN VALUTORE, ADMINISTRIMI I SAJ

Edhe gjate vitit 1996 Rezerva Valutore ka ruajtur te njejten strukture persa i perket menyres dhe elementeve te investimit te saj ne perputhje me objektivat e Politikes se Administrimit te tyre.

Niveli mesatar i Rezerves gjate ketij viti ka qene 260 milione USD. Gjate ketij viti Rezerva e Pergjithshme Valutore e Bankes se Shqiperise shenoi nje rritje prej 39 milione USD ose 16 per qind me shume se vitin e kaluar.

Ne fund te vitit 1996 stoku i rezerves arriti nivelin e 279 milione USD. Po te ndjekim nga pikepamja kohore trendin e rezerves valutore gjate ketij viti rezerva valutore ka patur tendenca rritjeje dhe konkretisht dy kane qene momentet qe Rezerva Valutore pesoi nje rritje te dukshme nje hap te konsiderueshem ne krahasim me ndryshimet relativisht te vogla qe peson rezerva nga faktoret.

Do te veconim ne keto momente hyrjen nga Komuniteti Evropian te rreth 25 milione USD si pjesa e dyte e transhit te trete ndihme nga Komuniteti Evropian per mbeshtetjen e Bilancit te Pagesave qe e coi Rezerven ne nivelet e 276 milione USD dhe marrjen e arit shqiptar te rembyer nga nazistet gjate Luftes se Dyte Boterore.

Duhet thene qe ky ar ne vlere rreth 18 milione USD eshte ne posedimin tone por ne Rezerven Valutore nuk ka gjetur akoma pasqyrim ndaj dhe ndikimi i tij nuk ndihet gjate ndryshimeve te rezerves me 1996.

Niveli i rezerves valutore ndryshon ne varesi te faktoreve qe ndikojne ne te. Keta jane te ndryshem por ne do t'i ndajme ne dy grupe te medha:

- ne faktore qe ndikojne ne ndryshimin fizik nominal te rezerves;
- ne faktore qe ndikojne ne ndryshimin vleror te rezerves ne momentin e vleresimit te saj.

Ne grupin e pare jane permbledhur gjithte faktoret qe ndikojne drejtpersedrejti ne shtimin ose pakesimin e rezerves nepermjet hyrjes dhe daljeve te fondeve te ndryshem ne xhepat e rezerves. Keta faktore perbehen nga hyrjet dhe daljet e donatoreve, institute nderkombetare financiare, fondacione, qeveri te huaja, G-24, projekte etj. Te gjitha keto ndihma e kredi te tyre te akorduara per Shqiperine, perbehen nga transaksione forex-i qe kryhen nga Banka e Shqiperise ne dobi te rezerves ose klienteve te saj, nga vjelja e interesave te investimit te rezerves, rezervat e detyrueshme te bankave te nivelit te dyte, vendosja e depozitave te bankave te ndryshme prane BOA, pagesat per borxhin e jashtem, kredite e ndryshme, per detyrimet e FMN e shume e shume hyrje e dalje qe behen ne favor te BOA dhe klienteve te saj.

Ne grupin e dyte do te vecojme, ndikimin e ndryshimit te kursit valutor ne momente te ndryshme sipas situatave te tregut

nderkombetar dhe atij te brendshem. Ky faktor konsiderohet i rëndesishem per vete faktin se ne momentin e vleresimit te rezerves kursi mund te jete me i ulet ose me i larte se nje moment tjetër vleresimi me perpara dhe keshtu rezerva nga nje moment ne tjetrin rritet dhe ulet. Per te minimizuar ne njefare mase riskun nga ndryshimi i kursit politika qe ka ndjekur Banka e Shqiperise ka qene qe gjate gjithë vitit 1996 te ruaje stabilitetin e krijuar ne treg me qellimin e eleminimit ne maksimum te nderhyrjeve ne treg nepermjet rezerves valutore. Per kete qellim gjate periudhes prill maj 1996, rezerva pesoi nje renie relativisht te vogel si rezultat i ndikimit te nderhyrjes ne treg nga ana e Bankes se Shqiperise per te lekundur sentimentin bullish qe ishte krijuar ne treg me rastin e zgjedhjeve te reja parlamentare. Duhet thene qe keto rezultate jane te zakonshme ne praktiken e tregjeve nderkombetare.

Perveç kesaj, per te eleminuar kete risk shfrytezohen informacionet e tregut nderkombetar dhe atij te brendshem per parashikimin e ecurise se tij dhe investohet ne masen me te madhe te rezerves ne periudha kohe te shkurtra.

Po gjate vitit 1996, ne administrimin e Rezerves Valutore eshte punuar per te realizuar nje fitim relativisht ne rritje ne krahasim me fitimin e planifikuar megjithese kjo varet ne njefare menyre dhe nga perqindja e ofruar nga BIS Basle pasi gjithë fondet jane investuar ne BIS Basle.

Ne lidhje me gjendjen e investimit te Rezerves Valutore rreth 1% e saj eshte ne llogari, 3% ne llogari njeditore, 76% e saj eshte ne depozite njejavore dhe 20% ne depozite njemujore ndersa ne vlere absolute ato qendrojne ne shifrat perkatesisht:

- rreth 2.4 milione USD ne llogari
- " 10.81 milione USD llogari njeditore
- " 207 milione ne depozite njejavore
- " 58.26 milione ne depozite njemujore

ne pergjithesi kjo eshte nje strukture qe ruhet gjate investimit te rezerves por ka akoma pune per te bere ne lidhje me investimin e instrumenteve te tjere ne perberje te rezerves.

Duhet thene qe nga praktika e punes levizjet e saj me te dukshme rezerva i ka ne fund te periudhave tremujore te vitit, kjo per faktin se shume detyrime ne valute te Ministrise se Financave, Bankes se Shqiperise etj. kane maturim shlyerjeje ne keto periudha.

3.3 TREGU DHE KEMBIMET VALUTORE

Gjate vitit 1996, tregu i kembimeve valutore njohu rritje te vellimit te aktivitetit te tij, si dhe te numrit te pjesemarresve, si rezultat i shtimit te zyrave te kembimit valutor dhe bankave te reja te licencuara. Ne vitin 1995, operonin gjithesej 11 zyra te kembimit valutor, ndersa ne fund te vitit 1996, numri i tyre ishte 23 (ketu nuk perfshihen 6 zyra postare). Per here te pare u licencuan per kryerjen e aktivitetit valutor, 13 zyra kembimi. Gjate gjysmes se dyte te vitit 1996, ne sistemin bankar shqiptar u shtuan edhe dy banka te reja. Ne nje treg te lire, ku cmimi i produktit qe tregtohet vendoset mbi bazen e kerkeses dhe ofertes, shtimi i numrit te pjesemarresve garanton percaktimin e nje niveli me real te cmimit dhe njeherazi nje treg me te stabilizuar.


Por viti 1996, krahas fenomeneve ekonomiko - financiare, ishte i pasur edhe me ngjarje politike, te cilat ne nje ekonomi tregu te lire, ndikojne mbi tregjet ne pergjithesi. Si te tillat ato kane ndikimin e tyre edhe mbi tregun valutor e kurset e kembimit.

Nen ndikimin e ketyre faktoreve, gjate vitit te kaluar, Leku u zhvleresua kundrejt valutave kryesore.

Keshtu ne fillim te vitit 1996, kursi i kembimit USD/Lek ishte 95.00 (i cili perfaqeson edhe nivelin me te ulet te vitit), u ngjiti ne nivelin me te larte ne fillim te muajit prill me 118.65 leke dhe ne fund te vitit, shenonte nivelin 103.80 leke. I shprehur ne perqindje, ky zhvleresim eshte 9.30 per qind. E ngjashme ka qene edhe ecuria e kursit te kembimit DEM/Lek. Ne fillim te vitit DEM u kembye kundrejt Lekut ne nivelin 65.80, u ngjiti ne nivelin me te larte ne fillim te muajit prill me 77.50 leke, zbriti ne nivelin me te ulet ne mes te muajit tetor me 64.00 leke, dhe u mbyll ne fund te vitit ne nivelin 67.00 leke. I shprehur ne perqindje, zhvleresimi i Lekut ndaj DEM per vitin 1996, eshte 1.80 per qind.

Kundrejt valutave te tjera kryesore ne tregun tone valutor, si Lireta italiane dhe Dhrahmia greke, Leku eshte zhvleresuar perkatesisht 13 per qind dhe 3 per qind. Sic mund te shihet, shkalla e zhvleresimit per valuta te ndryshme eshte e ndryshme, duke reflektuar kurset e kembimit te ketyre valutave mes njera - tjetres, ndryshimin qe ato kane pesuar gjate vitit te kaluar ne tregun nderkombetar si dhe shkallen e perdorimit te tyre ne marredheniet ekonomiko-tregtare te vendit tone me boten. Monedha amerikane eshte vleresuar ndjeshem ndaj valutave te tjera duke reflektuar zhvillimet ekonomike mjaft pozitive ne SHBA, si dhe masat qe kane ndermarre vendet me te zhvilluara evropiane ne kuadrin e integritimit ne Bashkimin Monetar Evropian dhe krijimin e monedhes unike.

Nese analizohet ritmi i zhvleresimit te Lekut ndaj valutave kryesore, vihet re se ai ka qene shume me i shpejte ne muajt e pare te vitit 1996. Faktor kryesor per kete ecuri, ishin zgjedhjet elektorale per pushtetin qendror dhe pasiguria rreth rezultatit te tyre. Kjo beri qe veprimtaria ne tregun valutor te merrte karakter te theksuar spekulativ. Per te frenuar nje fenomen te tille dhe minimizuar demin ekonomik qe e shoqeron, nderhyri ne treg duke



Graf. 3.5. Kursi i kembimit; Mesatarja e periudhes
 Leke / USD
 Leke / DEM
 Leke / 100 GRD
 Leke / 1000 ITL

shitur valute (USD) Banka e Shqiperise, si autoriteti i vetem financiar, pergjegjes per stabilitetin e cmimeve. Per nje periudhe gati 3-mujore, gjate se ciles Banka e Shqiperise nderhyri ne menyre te vazhdueshme, jane shitur ne treg rreth 25 milione USD. Si rezultat i kesaj nderhyrjeje, si dhe i eliminimit te faktorit shkaktues, tregu valutor u stabilizua dhe qe nga muaji qershor e deri ne mes te muajit nentor, shfaqti nje trend te vazhdueshem ne renie te kurseve te kembimit te valutave kundrejt Lekut. Ky ritem ka qene me i shpejte ne periudhen tetor - nentor dhe shkak kryesor per kete dukuri, ishte rritja e normave te interesit qe ofroheshin per depozitat ne Lek ne tregun joformal. Si rezultat, kursi i kembimit USD/Lek ra ne nivelin 97.50, prane nivelit me te ulet te vitit (Lek 95.00).

Me afrimin e festave te fundvitit (ashtu sic ka ndodhur ne te njejten periudhe te viteve te kaluara), rritja e vellimit te importeve per plotesimin e kerkesave te tregut, u shoqerua me nje rritje te kerkeses per valute dhe zhvleresim te Lekut.

Viti 1996, u karakterizua nga nje volatilitet i larte i kurseve te kembimit ne tregun valutor, krahasuar me vitin 1995. Psh, kursi i kembimit USD/Lek ne vitin e kaluar eshte luhatur ne kufijte 95.00 - 118.65, ndersa ne vitin 1995 banda e levizjes se ketij kursi ishte 89.00 - 96.50. I shprehur ne perqindje, volatiliteti ne vitin '96 eshte 24.9 per qind, krahasuar me 8.4 per qind qe ishte ne vitin '95.

4. SISTEMI BANKAR DHE PERSOSJA E TIJ

4.1 PERSOSJA E BAZES LIGJORE

Baza e plote ligjore mbi rregullshmerine e kryerjes se aktiviteteve bankare, krijuar qe ne vitin 1992, u persos edhe me shume, me miratimin nga Kuvendi Popullor ne shkurt te vitit 1996, te ndryshimeve te formuluar ne dy ligje te reja baze, sic jane: Ligji Nr. 8076 "Per Banken e Shqiperise", dhe Ligji Nr. 8075 "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise.

4.1.1 LIGJI "PER BANKEN E SHQIPERISE"

Ligji "Per Banken e Shqiperise" percakton qarte dhe pa ekuivoke pavaresine institucionale te bankes qendrore, pavaresi e cila ne kushte te caktura eshte jetike. Me sakte ky Ligj parashikon:

- Percaktimin e objektivave kryesore te Bankes se Shqiperise perkundrejt dimensionimit te realizimit te tyre.
- Percaktimin e politikës se kembimeve dhe te administrimit te rezervave valutore.
- Organizimin dhe administrimin e Bankes se Shqiperise.
- Kufijte reale dhe ekzekutive per kredine e Bankes se Shqiperise per Qeverine.

Nje percaktim me i sakte i objektivave eshte gjykuar i nevojshem duke patur parasysh pavaresine e parashikuar per Banken e Shqiperise ne ligj, dhe duke marre ne konsiderate nevojen per te gjykuar se si Banka e Shqiperise eshte duke zbatuar detyrat e saj.

Stabiliteti monetar eshte nje nga udhekryqet ne te cilat ekonomite e konsoliduara jane ndertuar. Historikisht, ka qene e veshtire per vendet e ndryshme ta ruajne vleren e monedhes se tyre. Ne te vertete kjo eshte rrjedhoje e faktit qe bankave qendrore u eshte kerkuar te arrijne shume objektiva kontradiktore. Shkaku kryesor i deshtimit te shume bankave qendrore ne arritjen e stabilitetit te cmimeve kane qene kerkesat e qeverive qe bankat qendrore te ndihmojne ne financimin e shpenzimeve publike ose te ndjekin realizimin e objektivave afatshkurtra (p.sh. ulja e papunesise, stimulimi i investimeve, rregullimi i fitimeve te bankave). Megjithate, pavaresisht nga shmangiet ne praktike, pervoja ka treguar se nje nga objektivat te cilin bankat qendrore teknikisht mund ta realizojne, eshte stabiliteti i cmimeve.

Keshtu, duke parashikuar ne ligj, ne menyre joekuivoke, se objektivi kryesor i Bankes se Shqiperise eshte ruajtja e stabilitetit te cmimeve dhe, te gjitha objektivat e tjere jane konsideruar si mbeshtetes, mendohet se eshte bere nje percaktim i drejte dhe i rendesishem.

Ligji per Banken Qendrore specifikon rolin e saj dhe te Qeverise ne politiken e kembimeve valutore, p.sh. kush vendos per regjimin e kembimeve valutore te vendit, kush i vendos perqindjet e kembimeve, dhe kush eshte pergjegjes per

operacionet e kembimeve valutore dhe administrimin e rezerves valutore, sepse arritja e stabilitetit te cmimeve behet e mundur kryesisht nepermjet nje kontrolli te plote mbi politiken e kembimeve valutore.

Ligji "Per Banken e Shqiperise" specifikon, gjithashtu, pergjegjesite e Bankes se Shqiperise ne ceshtje te tilla sic jane: kontrolli ne kembimet, mbikeqyrja e operacioneve te kembimeve valutore, administrimi i rezervave zyrtare nderkombetare.

Ne ligj jane percaktuar te drejtat dhe pergjegjesite e organeve drejtuese te Bankes se Shqiperise, e vecanerisht te Keshillit Mbikeqyres, si organi me i larte drejtues i Bankes se Shqiperise.

Ligji "Per Banken e Shqiperise" percakton se kufijte vjetore mbi kredine e Bankes se Shqiperise per Qeverine duhet te jene te parapercaktuar, sipas nevojave per te patur nje politike fiskale te kenaqshme dhe per te vazhduar efektivitetin ne administrimin monetar si dhe permban kufizimet per blerjen nga Banka e Shqiperise te letrave me vlere te Qeverise:

4.1.2 NE LIDHJE ME LIGJIN "PER SISTEMIN BANKAR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE"

Ky ligj ne menyre te permbledhur, parashikon:

Rregullat per licencimin e bankave te nivelit te dyte dhe institucioneve te tjera financiare qe kryejne veprimtari bankare;

Organizimin dhe drejtimin e bankave; Ne strukturen e organeve drejtuese, Keshilli i Mbikeqyrjes eshte zevendesuar nga mbledhja e pergjithshme e aksionereve dhe problemet e formulimit te politikave se bankes dhe funksionet e zbatimit i jane lene Keshillit te Drejtuesve, duke e gjykuar si forme me te pershtateshme ne percaktimin e pergjegjesise per administrimin dhe drejtimin e bankes.

Operacionet bankare qe mund te kryeje nje banke me kapital minimal dhe kushtet qe ajo duhet te plotesoje per te kryer operacione me te komplikuar dhe me rrezik me te madh;

Te drejten e administrimit te portofolit te investimeve, operacione te letrave me vlere te borxhit, dhe tregtimit te letrave me vlere te pronesise, etj.;

Marrjen ne kujdestari dhe likuidimin e bankave, duke marre parasysh pervojen e vendeve te tjera ne kete fushe dhe harmonizimin e ketij kapitulli me rregullat dhe kriteret qe zbatohen per falimentimet;

Rregullat per mbikeqyrjen dhe raportimin nga firmat dhe institucionet jobankare qe kryejne operacione bankare;

Dispozita per kualifikimin dhe cilesite e administratorëve, sekretin, konfliktet e interesave, parandalimin e pastrimit te parave me origjine nga aktivitetet kriminale si droga, tregtia e armeve, etj.;

4.2 MBIKEQYRJA BANKARE, KONTROLLI DHE SISTEMI RREGULLUES

Per te realizuar sa me mire objektivat shume te rendesishem te mbikeqyrjes bankare edhe gjate vitit 1996 u punua intensivisht per konsolidimin e metejsheem te Departamentit te Mbikeqyrjes si dhe per permiresimin cilesor te funksionimit te tij.

Ecuria dhe zgjerimi i aktivitetit te sistemit bankar, rritja e tij ne numer nga bankat e reja te licencuara si dhe miratimi nga kuvendi Popullor i dy ligjeve per "Banken e Shqiperise" dhe "Sistemin Bankar ne Republiken e Shqiperise" ne shkurt te vitit 1996, diktuan nevojën e perpunimit dhe miratimit te rregulloreve per:

- "Dhenien e licencave per te vepruar si banke ne Republiken e Shqiperise";
- "Mjaftueshmerine e fondeve te veta te bankes";
- "Mbi kerkesat qe duhet te plotesojne administratoret e bankave te nivelit te dyte".

Paralelisht me miratimin e ketyre rregulloreve u krye dhe puna pergatitore per hartimin e nje sere rregulloresh te tjera si :

- Rregullorja e "Tregut te kembimeve valutore";
- Rregullorja e "Normave te mbikeqyrjes per nivelin maksimal te kredive";
- Rregullorja per "Klasifikimin e huave dhe krijimin e fondit rezerve per mbulimin e humbjeve nga huate";
- "Manuali i inspektimit bankar", etj.

Ne perpunimin e rregulloreve nga ana e Departamentit eshte mbajtur parasysh ne teresi standartizimi i tyre, dmth percaktimi i normave te njejta per te gjitha bankat e nivelit te dyte si dhe vendosja e kriterëve te tilla qe t'u perafrohen standarteve nderkombetare per mbikeqyrjen bankare.

Ne Rregulloren mbi "Mjaftueshmerine e fondeve te veta te Bankes" kerkohet qe llogaritja e treguesit te behet nga vete bankat e nivelit te dyte, gje qe deri me sot behej nga Departamenti i Mbikeqyrjes. Gjithashtu, ne te paraqitet nje klasifikim me i detajuar i zerave te aktivitet dhe zerat jashte bilancit sipas shkalles se rrezikut; trajtohet koncepti i kontratave me norme interesi e kurse kembimi te ndryshueshem; paraqiten me te plota elementet e fondeve te veta te bankes duke futur dhe konceptin e kapitalit hibrid dhe borxhit te varur; si dhe percaktohet vetem nje norme per te gjitha bankat. Per me teper, Rregullorja permban dhe nje sere klauzolash se si do te veprojne bankat e nivelit te dyte qe paraqiten te pakapitalizuara.

Persa i perket projektregulloreve qe jane ne procesin e perfundimit dhe te miratimit eshte menduar qe te permiresohen disa norma te vendosura sipas kushteve dhe vecorive te sistemit bankar ne zhvillimet e tij. Keshtu per projektregulloren per "Normat e mbikeqyrjes mbi nivelin maksimal te kredise" eshte menduar te percaktohet nje nivel maksimal per te gjitha bankat e nivelit te dyte dhe kjo ne varesi te fondeve te veta si dhe shuma

maksimale e huase qe mund t'i jepet cdo klienti ose grupi huamarresish solidare. Gjithashtu, ne kete rregullore do te percaktohen edhe marredheniet qe duhet te kene bankat me punonjesit e saj dhe personat e lidhur me te.

Ndersa ne projektregulloren "Mbi klasifikimin e huave dhe krijimin e fondit rezerve per mbulimin e humbjeve nga huate" eshte menduar qe te llogariten provigjone per interesa te llogaritura por te paarketuara si rezultat i kalimit te kredive ne te pakthyera ne afat, fshirja e huave te humbura si dhe reduktimi i huave.

E rendesishme eshte qe gjate ketij viti u punua per hartimin e "Manualit te ekzaminimit bankar", manual i cili i ka munguar Departamentit te Mbikeqyrjes. Nepermjet ketij manuali eshte plotesuar baza e nevojshme e rregullave, funksioneve dhe procedurave qe jane te domosdoshme per nje inspektor te Bankes se Shqiperise. Manuali permban disa anekse dhe pyetesore qe perfaqesojne anen teknike te inspektimeve. Gjithashtu, ne manualin e ri eshte parashikuar qe ne inspektimet e ardhme te zbatohet edhe prej nesh sistemi CAMEL per vleresimin e gjendjes se bankave. Kjo gje kerkon pergatitjen e sistemit te vleresimit qe i referohet CAMEL-it dhe qe do te jete ne vemendje te punes se departamentit ne te ardhmen.

Gjate vitit 1996, Departamenti i Mbikeqyrjes nje rendesi te vecante i dha permiresimit te punes analizuese dhe studimore ne drejtim te respektimit te normave te mbikeqyrjes te vendosura nga Banka e Shqiperise si dhe ecurise se treguesve kryesore financiare te bankave te nivelit te dyte, tregues qe influencojne teresisht ne rezultatin financiar te tyre, duke i gershetuar ato me inspektime te pjeseshme apo te pergjitheshme.

Puna analizuese per ecurine e sistemit bankar nuk u perqendrua vetem ne nxjerrjen e treguesve mujore dhe tendencave te verejtura gjate muajit raportues ne aktivitetin e sistemit bankar por u shoqerua nga analiza tremujore per ecurine e gjendjes financiare te cdo banke ne vecanti duke nxjerre konkluzione konkrete dhe rruget per permiresimin e gjendjes. Keto analiza u bene me te plota si rezultat dhe i permiresimit qe iu be "Sistemit Raportues" qe bankat e nivelit te dyte raportojne prane Departamentit te Mbikeqyrjes ne korrik te vitit 1995.

Per te realizuar sa me sakte dhe korrekt analizat financiare dhe llogaritjet e treguesve kryesore te sistemit bankar eshte bere nje pune sistematike per saktesimin e treguesve te raportuar nga bankat e nivelit te dyte sidomos nga bankat e reja te licencuara duke bashkepunuar dhe kontrolluar te dhenat e raportuara.

Te dhenat mujore si dhe analizat financiare tremujore u shfrytezuan me mire per te programuar punen kontrolluese ne vend me nje tematike me te studiuar dhe me konkrete si dhe rritjen e tyre ne numer duke mbuluar pothuajse teresisht te gjitha bankat.

Keshtu, gjate ketij viti inspektime komplekse u bene ne Banken e Kursimeve dhe Banken Arabo-Shqiptare Islamike. Gjithashtu, u kryen inspektime te pjesshme ne Banken Tregtare Agrare si dhe kontrolle per zbatimin e detyrave te lena nga kontrollet e kryera ne vitin 1995 ne Banken Dardania dhe Banken Italo-Shqiptare. Inspektimet komplekse u pergendruan kryesisht ne problemet e kapitalizimit te bankave, cilesine e portofolit te huave, veprimeve dhe transaksioneve ne valute, te permiresimit te statutit te bankave si dhe ne problemet e organizimit dhe drejtimit ne teresi te bankes. Inspektimet e pjesshme paten si objekt kryesisht aktivitetin kreditues, aktivitet i cili paraqitej me mjaft probleme.

Problemet dhe dukurite e konstatuara, bene qe Departamenti i Mbikeqyrjes te organizonte dhe sistemin e ndjekjes operative te treguesve qe kishin paraqitur tendenca perkeqesimi apo kishin levizje shume te ndjeshme. Kjo beri qe te analizoheshin dhe te ndiqeshin me nga afer problemet shqetesuese per cdo banke ne vecanti dhe te reagohej ne kohe duke marre edhe masat perkatese qe ne disa raste kane shkuar edhe ne kufizimin e te drejtes se kredidhenies.

Nje vemendje e vecante ju kushtua ecurise dhe levizjeve te ndjeshme ne llogarite dhe depozitat e klienteve, fenomen i cili u vu re sidomos ne gjashtemujorin e dyte te vitit 1996. Nga ana jone u konstatua se nga bankat e nivelit te dyte nuk po zbatoheshin si duhet rregullat e terheqjes se cash-it. Per kete arsye si dhe per forcimin e kontrollit dhe parandalimit te pastrimit te parave, ne mungesen edhe te nje ligji te plote per parandalimin e ketij fenomeni, nga Departamenti i Mbikeqyrjes u pergatit "Formulari i veprimeve ne cash" si dhe "Deklarata per burimin e te ardhurave" me te cilat persona dhe firma te ndryshme kryenin transaksione nepermjet bankave si dhe kerkesa per te bere raportime mbi gjendjen e llogarive e depozitave ne periudha te ndryshme kohe.

4.3 PRIVATIZIMI I BANKAVE, LICENCIMI DHE KONSOLIDIMI I SISTEMIT BANKAR

4.3.1 PRIVATIZIMI I BANKAVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETEROR

Niveli aktual i zhvillimit të reformave në fushën ekonomike dhe sidomos hyrja në fazën përfundimtare të procesit të privatizimit masiv bën të nevojshme që ky proces të shtrihej edhe në fushën e sistemit bankar. Nga njëra anë privatizimi i bankave tregtare me kapital shtetëror shërben si një mjet për të fuqizuar nga ana institucionale këto banka, për të përmirësuar në tërësi punën e tyre, të hap rrugë zhvillimit teknologjik të industrisë bankare. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh që bankat tregtare me kapital shtetëror dominojnë në tregun bankar, madje do të thonim se mbi 90 për qind e aktivitetit të krejtë të sistemit bankar zhvillohet prej tyre, është me siguri e qartë që privatizimi do të çojë edhe në krijimin e një sistemi bankar të qëndrueshëm e të shëndoshe financiarisht, të aftë për të mbështetur zhvillimet e reja ekonomike të vendit dhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve që përdodhin në mjedisin ekonomik.

I gjithë ky proces do të kalojë nëpër tre faza.

4.3.1.1 Faza I. Krijimi i bazës ligjore që do të mbështesë procesin e privatizimit

Ligji Nr. 8033, datë 16.11.1995, për "Transformimin e bankave tregtare në shoqëri tregtare dhe lejimi i privatizimit të tyre", shërben si një pikënisje e gjithë këtij procesi. Ligji jep një kuader të plotë të çështjeve që do të trajtohen gjatë privatizimit duke nisur nga përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për këtë proces deri në veprimet që do të kryhen në fazat e tjera.

Ky ligj u pasua nga një sërë dekretesh e amendamentesh të tjera ligjore që rregullojnë anë të ndryshme të aktivitetit bankar. Dekreti për një shtesë në këtë ligj, Vendimi për "Regjistrimin e pasurive të paluajtshme në administrim të bankave të nivelit të dytë me kapital teresisht shtetëror", Vendimi për "Fillimin e procedurave për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të bankave të nivelit të dytë me kapital teresisht shtetëror" dhe Urdhri për "Krijimin e grupit të punës për hartimin e procedurave të punës për privatizimin e bankave".

Dokumenti më i rëndësishëm i miratuar gjatë kësaj faze është Vendimi "Për miratimin e strategjisë së privatizimit të bankave shtetërore". Dokumenti parashtron objektivat afatshkurter dhe afatmesëm të qeverisë për privatizimin e bankave, rolin e qeverisë, të Bankës së Shqipërisë dhe të vetë bankave në këtë proces. Në strategji janë përcaktuar në kapituj të veçantë :

- qëllimi i privatizimit të bankave shtetërore;
- objektivat e qeverisë në këtë proces;
- metodat e shitjes së bankave;
- fazat e detajuara të procesit të privatizimit;
- konsideratat për formulën dhe radhën e privatizimit;
- drejtuesit dhe keshilltaret e këtij procesi.

Konkretisht, si banka e pare per t'u privatizuar percaktohet Banka Tregtare Agrare e ndjekur nga Banka Kombetare Tregtare dhe me pas Banka e Kursimeve. Privatizimi teresor i ketyre bankave duhet te realizohet brenda vitit 2000.

Keshtu, **procesi do te drejtohet nga Ministria e Financave dhe ajo e Privatizimit**. Kete do ta realizojne ne bashkepunim me bankat qe do te privatizohen, keshilltaret e huaj, por sidomos me Banken e Shqiperise.

Ne kete pikepamje, Banka e Shqiperise ka nje detyre te vecante per te ndjekur nga afer procesin e privatizimit si proces i cili do ta zhvendose transformimin nga bankat e vecanta ne krejt sistemin bankar.

4.3.1.2 Faza II. Pergatitja e bankave per privatizim.

Faza e dyte e shenoi nisjen e saj me hartimin e nje pakete masash per secilen banke qe do te privatizohet. Masat e propozuara kane per qellim permiresimin e punes se bankes dhe paraqiten te vecanta per secilen banke ne perputhje me situaten e vecante te tyre dhe problemeve te ndryshme te pozuarra prej tyre. Ne pergjithesi masat e propozuara perqendrohen ne :

- problemet e kreditit;
- mjaftueshmerine e kapitalit;
- veprimtarine valutore;
- vleresimin e kuadrit rregullativ te vete bankes;
- licencimin e tyre ne baze te kerkesave te Ligjit Nr. 8075, date 22.02.1996, per "Sistemin Bankar ne Republiken e Shqiperise".;
- zbatimin me rigorozitet te rregullave e normave te Bankes se Shqiperise;
- forcimin e punes se kontrollit te brendeshem; si dhe
- permiresimin e procedurave kontabel.

Me tej u kalua ne nje aspekt me teknik me marrjen e Vendimit te Keshillit te Ministrave per "Riorganizimin e veprimtarise se Bankes se Kursimeve, Bankes Kombetare Tregtare dhe Bankes Tregtare Agrare". Ky dokument shenon hapin e pare konkret ne drejtim te ristrukturimit te rrjetit te degeve te ketyre bankave duke lejuar transferimin e nje sere degesh, agjencish dhe zyresh bankare nga Banka Kombetare Tregtare dhe Banka Tregtare Agrare ne Banken e Kursimeve dhe ristrukturimin e kesaj te fundit ne nje faze te dyte.

Ky vendim synon qe dy bankat te cilat jane te parat ne radhen e privatizimit te paraqiten me nje rrjet bankar me fleksibel e me te pranueshem per investitoret.

Nga ana e saj, Banka e Shqiperise do te ndjeke nga afer treguesit financiare te bankave dhe ndryshimet qe pesojne keta tregues nga kjo zhvendosje e rrjetit bankar ne funksion te ndikimit ne situaten financiare te tyre.

4.3.2 LICENCIMI I SISTEMIT BANKAR.

Miratimi i ligjeve per sistemin bankar ne shkurt te 1996 dhe kerkesat e reja qe ata shtruan ne drejtim te licencimit te bankave, kerkoi domosdoshmerisht qe ata te pasqyroheshin ne Rregulloren perkatese.

Me Vendimin Nr. 15 date 28.06.1996, kjo rregullore u miratua nga Keshilli Mbikeqyres i Bankes se Shqiperise me titullin "Rregullorja per dhenien e licencave per te vepruar si banke ne Republiken e Shqiperise". Miratimi i saj shenoi edhe fillimin e procesit te rishikimit te gjithë kuadrit rregullativ te Departamentit te Mbikeqyrjes.

Ne kete Rregullore percaktohen nje sere elementesh te rinj si:

- bankat te jene shoqeri aksionere ku kapitalin do t'a kene te ndare ne aksione me vlera nominale dhe qe pronare te tyre mund te jete shteti ose persona fizike ose juridike te ndryshem.
- shuma minimale e kapitalit te kerkuar eshte e njejte si per bankat me kapital shqiptar ashtu dhe per ato me kapital te huaj ose te perbashket. Po keshtu nga niveli i kapitalit te paguar do te varet edhe llojshmeria e veprimtarive qe i lejohen nje banke te kryeje.
- dhenia e licences ne dy afate. Fillimisht kerkuesit i jepet licenca paraprake dhe me plotesimin e kushteve te percaktuara ne Rregullore edhe ajo perfundimtare. Kjo kerkon qe edhe dokumentacioni perkates te paraqitet ne dy kohe te ndryshme.
- detajim me i madh i formulareve ku jepen te dhena per planet e biznesit te bankes. Kjo do te sherbeje per te realizuar nje gjykim me te mire per ecurine ose aktivitetin e suksesshem te bankes.
- perfshirja edhe e kerkesave te tjera qe sherbejne per dhenien e nje gjykimi me te plote e me te sakte per dhenien ose jo te licences. Ketu perfshihen te dhena per:
 - aksioneret e bankes qe kane nenshkruar 10 per qind ose me shume nga kapitali i nenshkruar i bankes. Keto te dhena jepen ne formatet e percaktuara ne "Raportin personal sekret";
 - administratoret e propozuar te bankes, per kualifikimin dhe pervojen e tyre per dhjete vjetet e fundit.
 - strukturen e kapitalit, meqenese banka eshte percaktuar te jete shoqeri anonime ku kapitalin do t'a kete te ndare ne aksione dhe dokumente qe duhet te publikoje per shitjen e aksioneve te tij.
- dokumentet qe duhet te paraqese nje banke e huaj per hapje dege ose per te investuar per hapjen e bankave te reja ne Shqiperi.

Lidhur me procesin e licencimit te bankave, karakteristike e vitit te kaluar ka qene nje fluks i madh kerkesash per te marre licencen per te vepruar si banke ne Republiken e Shqiperise. Keshtu kerkesa ka patur si nga banka te huaja ashtu dhe nga persona fizike e juridike shqiptare dhe te huaj. Gjithsej jane

paraqitur 7 kërkesa të shoqëruara me një dokumentacion të plote për t'u licencuar si banka, krahas kërkesave të tjera të cilat nuk kanë paraqitur dokumentacionin e plotë, por që disa prej tyre janë në procesin e plotësimit të tij .

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, gjatë vitit të kaluar më së pari licencë përfundimtare 2 banka greke si dhe janë dhënë 2 licenca paraprake, një për hapjen e bankës së investitorit maqedon të propozuar me emrin International Commercial Bank dhe tjetra për hapjen e degës së Alpha Credit Bank në Tiranë.

Për t'u vënë në dukje është se, nga kërkesat e paraqitura është bërë përpjekje për të zgjedhur dhe për të lejuar të veprojnë në Shqipëri banka të cilat janë me reputacion në vendin e tyre siç është Banka Kombëtare Greke dhe Banka e Pireut.

Karakteristikat e bankave greke të cilat kanë paraqitur kërkesën për t'u licencuar ishte se ato kanë shtrirje në vendet e tjera ish-socialiste të Ballkanit dhe Evropës Lindore ose kanë synime për t'u shtrirë edhe në këto vende. Në momentin e dhënë u gjykua që ishte më i pershtatshëm licencimi i Bankës Kombëtare Greke dhe i Bankës së Pireut, e para si një nga bankat më serioze dhe me të mëdha të Greqisë dhe e dyta si banka e parë private në Shqipëri.

Po kështu, edhe banka tjetër greke Alpha Credit Bank e pajisur me licencë paraprake është një nga bankat më të fuqishme me kapital teresisht privat në Greqi.

Marredhënia e mira politiko-ekonomike që ekzistojnë midis dy vendeve, prezenca e investitoreve maqedonë në Shqipëri, roli agresiv i këtij shteti në drejtim të investimeve shërbyen si premisa për licencimin e një banke private maqedonë në Shqipëri.

Përveç sa më sipër, gjatë vitit të kaluar filloi puna për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjes dhe Commercial Bank of Greece.

Rezultati i licencimeve të bëra gjatë vitit 1996 ishte zgjerimi i sistemit bankar shqiptar. Kështu, nga 6 banka që operonin gjatë vitit 1995, në 1996 spektri bankar shqiptar u rrit në 8 dhe përbëhet nga:

1. Banka me kapital shtetëror:

- Banka Kombëtare Tregtare
- Banka Tregtare Agrare
- Banka e Kursimeve

2. Banka me kapital të përbashkët

- Banka Italo-Shqiptare
- Banka Arabo-Shqiptare Islamike

3. Banka me kapital privat:

- Banka Dardania

4. Banka me kapital të huaj privat:

- Banka Tirana

5. Banka me kapital të huaj shtetëror:

- Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë

4.4 REFORMA NE SISTEMIN E KONTABILITETIT DHE TE PAGESAVE.

Aktualisht, sistemet kontabel te perdorura nga bankat pjesemarrrese ne sistemin bankar, ndryshojne nga njeri-tjetri, faktor ky qe veshtireson se tepermi punen e Bankes se Shqiperise ne procesin e konsolidimit te te dhenave nga njera ane dhe pranon mundesine e gabimeve te ndryshme statistikore ne anen tjetere. Ne kuadrin e reformes bankare ne Shqiperi, Banka e Shqiperise si autoriteti rregullator dhe mbikeqyrres i aktiviteteve ne sektorin bankar ne bashkepunim me Ministrine e Financave, ka kohe qe eshte perfshire ne realizimin projektit "Plani i ri i llogarive per sistemin bankar.

Ky projekt pervec se do te krijojte nje sistem ne perputhje te plote me standartet nderkombetare, do te mundesoje permbushjen e kerkesave te statistikes monetare dhe te mbikeqyrjes bankare, sqarimin e pozicionit te vertete financiar te bankave te nivelit te dyte, standartizimin e informacionit financiar, etj.

Ne kushtet e zhvillimeve te shpejta te ekonomise se vendit dhe te transformimeve te kryera ne sistemin tone bankar, nje sistem i zhvilluar pagesash do te nxiste me tej rritjen ekonomike, gje qe perben hapin kryesor per te realizuar nje sistem bankar te integruar.

Kryerja e pagesave, e konceptuar me te gjitha elementet e domosdoshem te nje sistemi modern pagesash, krahas shpejtesise dhe saktetise, do te permiresoje efektivitetin e politikes monetare, do te perballoje me sukses transferimet me vlere te medha ndermjet bankave, do te arrije krijimin e nje tregu nderkombetar efektiv, si dhe do te realizoje funksionimin me te mire te instrumenteve direkte dhe indirekte te kontrollit monetar.

Vizioni i Bankes se Shqiperise per te ardhmen eshte krijimi i nje sistemi nderbankar pagesash qe do t'i permbahet kerkesave te Komunitetit Evropian per kleringun dhe shlyerjen nderbankare i cili do te realizoje nje grup te plote te sherbimit te pagesave. Standartet e sherbimeve te ofruara nga bankat per klientet jane te ndryshueshme dhe eshte nevojte urgjente permiresimi i tyre. Standartet pengohen nga infrastruktura e jashtme e cila perben edhe shkakun kryesor te cilesise se ulet te sherbimit ndaj klienteles.

Permiresimi i standarteve te operacioneve, te cilat do te bejne parapergatitjen per ciklin e kleringut te shlyerjeve, eshte objektivi kryesor i fazes se pare te projektit, gjate se ciles do te punohet krahas persosjes se sistemit me urdher-xhirim edhe per alternativat e tjera te mjeteve te pagesave. Ka filluar puna per trajtimin ne vecanti te pagesave me vlere te madhe, nderkohe qe do te ndiqen me kujdes shkaqet e mundshme te mosperdorimit te ceqeve dhe marrjen e masave per perdorimin e gjere te tyre si instrument pagese.

5. REZULTATI FINANCIAR I VITIT 1996

Banka e Shqiperise per vitin 1996 rezultoi me nje fitim ne shume absolute rreth 5,224 milione leke nga 4,869 milione leke parashikuar ne planin financiar ose 107.29 % .

Faktoret e realizimit te fitimit te planifikuar analizohen nepermjet analizese se te ardhurave dhe te shpenzimeve.

Te ardhurat. Per vitin ushtrimor 1996 Banka e Shqiperise realizoi rreth 5,737 milione leke te ardhura nga 5,393 milione te planifikuara ,pra me nje tejkalim prej 344 milion leke ose me rreth 6.4 % .

Peshen specifike me te madhe ne realizimin e te ardhurave e perbejne te ardhurat nga interesat te cilat arrijne shumen rreth 5,717 milione leke ose 99.7% Nga te cilat:

- 4,569 milione leke ose 79.6 % e perbejne te ardhurat nga interesat, ku peshen kryesore e ze interesi nga kredia per Qeverine rreth 3,083 milione leke dhe interesa nga letra me vlere rreth 1,486 milione leke (interesi per kredi per financimin pjesor te deficitit te buxhetit te shtetit dhe interesi nga kredite e siguruara, obligacione te kooperativave bujqesore).
- 1,144.6 milione leke ose 20% perbejne te ardhurat nga interesi i depozitave ne bankat e huaja (depozita ne valute ne Bis Basle dhe Federal Reserve Bank N.Y., etj.).
- 3.5 milione leke perbejne te ardhurat nga bankat e vendit (interesi nga kredia Lombard dhe rifinancimi).
- Te ardhurat nga gjoha/rezerve e detyrueshme dhe tejkalim kufi kredie jane rreth 3 milione leke, kurse te ardhurat e tjera rreth 12 milione leke.

Gjithashtu, rezultojne rreth 5 milione leke te ardhura nga tregtimi i letrave me vlere ne Burse.

Shpenzimet. Shpenzimet per vitin 1996 ishin planifikuar ne masen rreth 524 milione leke dhe ne fakt u realizuan 513 milione leke ose 98%.

- Shpenzimet operative ne vitin ushtrimor u kryen 181 milione leke ose 35.3% te totalit te shpenzimeve.
- Shpenzimet per interesat ne depozitat u kryen 168 milione leke ose kundrejt totalit te shpenzimeve 32.7%.
- Shpenzimet e amortizimit rreth 158 milione leke ose 30.6%.
- Komisione ne valute rreth 5 milione leke ose 1%.
- Shpenzime te veçanta rreth 1 milione leke.

Si perfundim, Banka e Shqiperise mbylli vitin 1996 me rreth 5,224 milione leke fitim, i cili do te shperndahet me vendim te Keshillit Mbikeqyres konform ligjit "Per Banken e Shqiperise".

6. AKTIVITETE TE TJERA

6.1 ADMINISTRIMI I PARASE

Me 31.12.1996, emisioni i monedhes u vertetua 55,7 miliarde leke dhe me nje rritje ne krahasim me 31.12.1995 per 12,2 miliarde leke, ndersa monedha ne qarkullim ne krahasim me 31.12.1995 u rrit vetem per 7,6 miliarde leke.

Rritja e emisionit te monedhes dhe e parase ne qarkullim ne vitin 1996 eshte vertetuar ne nivele me te ulta se rritja e vitit 1995 ndaj vitit 1994. Kjo edhe per rrjedhoje te zgjerimit te formave te pagesave me para jo *Cash*, por me kalime ne llogari, rruge e cila gjate vitit 1997 do te zgjerohet me tej. Ne kete drejtim do te ndikojte edhe ristrukturimi i Sistemit Bankar, privatizimi i bankave me kapital shteteror si dhe shtimi i numrit te bankave te licencuara qe veprojne ne Shqiperi.

Struktura e monedhes ne qarkullim ne fund te vitit 1996 paraqitet ne tabelen e meposhtme:

Tabela 5.1 Struktura e monedhes ne qarkullim

Prerjet	Numer		Vlere	
	Mije cope	%	Mije leke	%
K/monedha	24,153	10.54%	24,152,700	48.09%
1000				
500	37,097	16.19%	18,548,300	36.94%
200	29,377	12.82%	5,875,435	11.70%
100	10,221	4.46%	1,022,070	2.04%
50	4,688	2.05%	234,416	0.47%
10	16,671	7.28%	166,705	0.34%
5	9,752	4.26%	48,761	0.10%
3	6,924	3.02%	20,773	0.05%
1	21,818	9.52%	21,818	0.05%
M/monedha				
50	1,325	0.58%	66,275	0.14%
20	1,305	0.57%	26,110	0.06%
10	1,280	0.56%	12,805	0.03%
5	1,535	0.67%	7,677	0.02%
2	268	0.12%	537	0.01%
1	8,692	3.79%	8,692	0.02%
0.5	8,813	3.85%	4,407	0.01%
0.2	18,944	8.27%	3,789	0.01%
0.1	22,109	9.65%	2,211	0.01%
0.05	4,165	1.82%	208	0.00%
Total	229137	100%	50.223.690	100%

Me qellim qe monedha ne qarkullim te jete ne nje gjendje sa me te mire, Banka e Shqiperise vazhdimisht ka terhequr nga qarkullimi kartemonedhat e demtuara duke i zevendesuar ato me kartemonedha te reja. Keshtu, gjate vitit 1996 u asgjesuan rreth 15,7 milione cope kartemonedha kryesisht te prerjeve 200, 100, 50 dhe 10 leke te emetuara ne vitet 1976, 1991,1992. Kjo shifer eshte

relativisht e larte, por duke marre parasysh dhe ato qe ndodhen, mendohet qe sasia e monedhes qe duhet terhequr nga qarkullimi te jete edhe me e madhe. Ne mungese te nje kontrolli dhe perpunimi te automatizuar te kartemonedhave, eshte e kuptueshme qe kjo shifer te vazhdoje te jete e larte.

Ne zbatim te vendimeve te marra nga Banka e Shqiperise per nje emision krejtesisht te ri te monedhes kombetare shqiptare, eshte bere e mundur qe 01.01.1997 te hidhen ne qarkullim monedhat metalike te emisionit te ri te prerjeve 1 lek, 5 leke, 10 leke, 20 leke dhe 50 leke.

Monedhat metalike te prerjeve 5 leke, 10 leke, 20 leke dhe 50 leke emetohen per here te pare. Njeheresh edhe monedhat metalike te emetuara me pare do te vazhdojne te jene ne qarkullim dhe do te kene kurs ligjor deri ne nje Njoftim te dyte te Bankes se Shqiperise.

Emetimi i monedhave metalike te reja ndikon ne permiresimin e struktures se parase ne qarkullim sipas prerjeve si dhe ne raport me kartemonedhat.

Gjithashtu, ne vitin 1996 perfunduan gjithe procedurat per emetimin e nje serie te re te kartemonedhes kombetare shqiptare, emisioni i cili parashikohet te hidhet ne qarkullim gjate vitit 1997.

Ky emision do t'i sherbeje me mire kerkesave te stadit aktual dhe perspektiv te zhvillimit te ekonomise shqiptare ne rrugen e ekonomise se tregut. Ne faktoret qe cuan pergatitjen e emisionit te ri me nje strukture me te avancuar dhe me me pak prerje mund te permendim, vete konceptin "ekonomia e tregut", fuqine blerese te lekut, cmimet e mallrave dhe te sherbimeve, rritjen e qarkullimit te monedhes ne sasi dhe vlere per shkak te perqindjes se larte te transakcioneve qe kryhen ne baze "cash", konvertimet ne tregun valutor, numrin e madh te prerjeve te kartemonedhes ekzistuese, ruajtjen e tradites etj. Duke ju referuar struktures se re do te theksonim shtimin e kartemonedhes se prerjes 5000 leke qe i sherben me mire perspektives se afert te zhvillimeve ekonomike ne vend. Ne ndryshim nga emisionet e meparshem, emisioni i ri i monedhes shqiptare do te jete cilesisht shume i avancuar. Elemente te rinj sigurie qe shprehin arritjet me te fundit ne tekniken e prodhimit dhe te perdorimit te tyre do te perdoren gjeresisht ne kete emision te ri te kartemonedhes kombetare.

6.2 BURIMET NJEREZORE DHE KUALIFIKIMI I TYRE

Zhvillimi i Burimeve Njerezore ne veprimtarine e vitit 1996, eshte bazuar ne mobilizimin e personelit te Bankes per realizimin e objektivave te Bankes se Shqiperise te percaktuara ne Ligjin 8076 date 22.2.1996 "Per Banken e Shqiperise".

Ky mobilizim eshte mbeshtetur kryesisht ne venien ne zbatim te politikave te miratuara nga Keshilli Mbiqyres i bankes per zhvillimin e veprimtarise se departamentit te Organizimit dhe Zhvillimit te Burimeve Njerezore.

6.2.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ORGANIKA

Ne permbushjen e detyrave te bankes, persosja e struktures organizative dhe plotesimi gjithnje e me mire, (hap pas hapi) i organikes, kane luajtur nje rol te ndjeshem.

Krijimi i departamentit te Burses se Tiranes, shenoi nje hap te rendesishem ne fushen e politikës bankare dhe financiare.

Po ne kete vit, eshte riorganizuar struktura organizative e departamentit te Emisionit dhe Administrimit te Parase, cka behej e domosdoshme si rrjedhoje e mbylljes se veprimtarise se filialeve ne Tirane dhe Mat.

Ne kuadrin e masave per rritjen e sigurise dhe mbrojtjes se bankes, u bene permiresime ne strukturen e sektorit te Sigurimit.

Per t'ju pergjigjur ne kohe nevojave te bankes ne fushen e prokurimit, ne strukturen e departamentit te Administrimit, u krijua njesia e Prokurimit ne rang sektori, c'ka i pergjigjet detyrave te vendimit te Keshillit te Ministrave per kete qellim.

Keshtu struktura organizative ne fund te vitit 1996 (sipas pasqyres bashkengjitur), perbehet nga 10 departamente e sektore, kabineti dhe 5 filiale ne rrethet Shkoder, Elbasan, Lushnje, Korce, Gjirokaster.

Organika ne fund te vitit 1996 (31.12.1996) ne fakt arriti ne 305 punonjes (vende pune te plotesuara).

6.2.2 GJENDJA E PERSONELIT DHE PAGAT

Ne pranimin e punonjesve ne pune ne Banken e Shqiperise eshte zbatuar politika dhe procedurat e miratuara, ku ne bashkepunim me departamentet jane perzgjedhur kandidatet me te mundshem dhe jane punesuar.

Deri ne fund te vitit 1996 jane punesuar ne banke gjithsej 29 punonjes. Po keshtu ne vijim te nevojave te Bankes se Shqiperise jane bere levizje dhe emerime (transferime te brendeshme) te punonjesve, numri i te cilave arrin ne 26.

Plotesimi i vendeve te punes ne departamente duke ndjekur emerimet brendaperbrenda bankes dhe kombinuar me emerime te reja jashte saj, ka bere qe te kombinohet eksperienca e

njerezve te kualifikuar, duke synuar rritjen sa me aktive te veprimtarise se departamenteve.

Gjendja e personelit ne fund te vitit eshte :

Sipas shkalles arsimore	Aparat	Filiale	Gjithsej
Me arsim te larte	116 -56%	26-43%	142-52%
Me arsim te mesem	92-44%	35-57%	127-48%

Punonjesit me arsim te larte zene 52,8 per qind dhe ata me arsim te mesem 47,2 per qind. Niveli i numrit te punonjesve me arsim te mesem kushtezohet nga punet qe kerkojne me pak kualifikim sic jane perpunuesit e fondeve dhe punonjesit e tjere te prapavijes.

Perberja e personelit sipas grupmoshes, paraqet me se miri kombinimin e punonjesve te rinj me ato me eksperience. Me dominuese eshte grupmosha 31 - 40 vjec, 42 per qind dhe grupmosha deri 30 vjec, 30 per qind. Mosha mesatare ne Banken e Shqiperise ne fund te vitit 1996 eshte 37 vjec (aparat 36, ne filiale 39 vjec).

Per ta bere sa me eficente politiken e pagave, u punua per liberalizimin e pages mesatare dhe shkeputjen nga paga mesatare e kontrollueshme e vendosur nga Keshilli i Ministrave.

Nga rritjet e bera te pages, ne Banken e Shqiperise u realizua nje page mesatare 20.500 leke ne muaj, c'ka tregon per nje politike page shume te moderuar dhe efektive per te stimuluar jo vetem vendet e punes, por edhe punonjesit e saj duke zgjidhur deri ne nje shkalle te mjaftueshme dhe te kenaqshme kerkesat e tyre.

Kjo politike page e realizuar, ka bere, qe punonjesit te jene me te predispozuar per te rritur mobilizimin dhe pergjegjesine ne pune, ka favorizuar zgjedhjen e specialisteve me aftesi profesionale me te mira, si dhe frenimin e rrjedhjes se nepunesve te Bankes.

6.2.3 ASISTENCA TEKNIKE DHE KUALIFIKIMI

Edhe gjate vitit 1996, asistenca teknike ka konsistuar ne marrjen e asistences konkrete nga keshilltare rezidente ne Banken e Shqiperise, duke punuar ne fushat si:

- Operacionet Monetare,
- Mbiqyrja bankare, licencimi i bankave private,
- Kontabiliteti, sistemi i pagesave,
- Zhvillimi i tregut te kapitalit (Bursa e Tiranes),
- Permiresimi i ligjit te Bankes se Shqiperise.

Mbi bazen e kesaj asistence te marre, u be e mundur qe Banka e Shqiperise te realizoje disa nga projektet e saja si :

- Ndryshimet ne ligjin e Bankes se Shqiperise dhe te sistemit bankar ne Shqiperi.
- Krijimin e Burses se Tiranes,

- Plotesimin e kuadrit te plote ligjor mbi licencimin e bankave private

Banka e Shqiperise, nepermjet asistences teknike te marre po punon mbi projekte te tilla si ai per planin e ri te llogarive, ai per sistemin e pagesave, etj.

Nga perfitimi i asistences teknike per krijimin e tregut te kapitalit, u be e mundur te krijohet departamenti i Burses se Tiranes. Ne aspektin e infrastruktures ligjore nga Parlamenti Shqiptar u miratua Ligji Nr.8080 date 01.03.1996 "Per letrat me vlere".

Gjate vitit 1996 jane kualifikuar jashte shtetit 113 punonjes me dite qendrimi mesatar 8,4 dite ose 44 per qind. Per vitin 1996 asistenca teknike per kualifikime eshte afruar nga F.M.N, BIS, Banca D'italia, Banka Kombetare e Austrise, Banka e Anglise, U.S.A.I.D.-i, Federal Reserve Bank, Departamenti i Thesarit, C.E.E.P.N, Bursa e Lubjanes dhe te tjere donatore.

Banka e Shqiperise, nepermjet Qendres se Trainimit te saj, ka kerkuar te luaje nje rol efektiv ne trainimin e punonjesve te sistemit bankar ne Shqiperi, ku jane kualifikuar rreth 36 punonjes nga Banka e Shqiperise.

Gjate ketij viti eshte bashkepunuar me institucione te rendesishme si UBS Zvicer, Internal Development Law Institute, USAID-i per seminarin "Vleresimi i kolateraleve, Internal Development Law Institute, per seminarin "Aspekte ligjore te veprimtarise te Burses", Federal Reserve Bank, seminarin per dollarin e ri te hedhur ne qarkullim, etj.

Qendra e Trainimit ne bashkepunim me Universitetin e Tiranes, Fakultetin Ekonomik, ka organizuar seminare per sistemin bankar, mbi bazen e nje programi te hartuar mbi nevojat me te domosdoshme. Kete vit ne kete qender jane trainuar nje numer i konsiderueshem punonjesish te sistemit bankar.

6.3 BURSA E TIRANES

Puna per krijimin e Burses se Tiranes i ka fillimet e saj ne tetor 1995, kur prane Bankes se Shqiperise asistojne ekspertet e kompanise britanike GMA Capital Market LTD, e mirenjohur ne fushen e konsulences nderkombetare. Nen asistencen e kesaj kompanie u realizua pergatitja e kuadrit ligjor te domosdoshem per krijimin e tregut te kapitaleve ne Shqiperi. Gjithsesi, 2 maji i vitit 1996, shenoi *de jure* hapjen zyrtare te te pares burse ne Shqiperi, e cila fillimisht u gjykua te jete nje departament i vecante ne Banken e Shqiperise.

6.3.1 TREGTIMI NE BURSEN E TIRANES

Bursa e Tiranes eshte organizuar si nje treg "open outcry" dhe i drejtuar nga urdhri (porosia). Sesionet e tregtimit zhvillohen dy here ne jave ku pastrimi dhe rregullimi i llogarive kryhet po nga Bursa e Tiranes. Instrumentet e tregtueshme jane Bonot e Thesarit dhe Obligacionet qeveritare.

Gjate vitit 1996, ne tregun primar, jane emetuar gjithsej 71.7 miliarde leke Bono Thesari, nga te cilat perkatesisht 24.5 miliarde leke , 13.7 miliarde leke e 23.5 miliarde leke me maturim 3-mujor, 6 -mujor dhe 12-mujor.

Tregtimi ne Bursen e Tiranes gjate tete muajve te aktivitetit te saj, eshte karakterizuar nga nje numer shume i kufizuar transakSIONESH te ekzekutuara dhe volum i ulet tregtimi. Tregtaret me aktive kane qene Banka Kombetare Tregtare dhe ajo e Kursimeve, te cilat se bashku kane ekzekutuar transakSIONE shitblerjeje ne mbi 60 per qind te totalit te tyre; Banka e Shqiperise, me rreth 30 per qind ndaj totalit ka qene krejtesisht ne pozicionin e shitesit.

Per vitin 1996, mund te thuhet se, Bursa e Tiranes ka operuar kryesisht si nje treg pjesor paraje (me nje kuader jo te plote instrumentesh te tij) dhe si nje treg i ngushte dhe jo likuid kapitalesh (i perfaqesuar nga obligacionet qeveritare).

6.3.2 ANETARESIMI DHE LISTIMI

Antare te Burses se Tiranes, pavaresisht nga forma jo e plote e funksionimit te tyre si te tille, aktualisht jane Banka e Shqiperise, kater bankat tregtare te nivelit te dyte, INSIG dhe individe.

Gjate vitit 1996, ne Bursen e Tiranes nuk u listua asnje kompani. Nga paketa e 20 shoqerive aksionere rezultuan mangesi te theksuara te cilat e benin plotesisht te pamundur listimin e tyre ne Burse. Menaxhimi dhe administrimi financiar teper i dobet, mosberja publike e dokumenteve financiare, sipas Ligjit mbi Shoqerite Tregtare, borxhet e medha financiare, bilancet ekonomike negative, pamjaftueshmeria e kapitalit minimal ne perputhje me Ligjin e Letrave me Vlere, e nje sere shkaqesh te tjera llogariten si faktore kryesore qe nuk mundesuan listimin e tyre ne Bursen e Tiranes.

Permbajtja:

1. VESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI EKONOMINE	1-0
1.1 ZHVILLIMI I EKONOMISE KOMBETARE	1-2
1.2 KERKESA E BRENDSHME DHE PRESIONET INFLACIONISTE	1-6
1.3 CMIMET E KONSUMIT	1-9
1.4 PUNESIMI DHE TE ARDHURAT	1-12
2. POLITIKA DHE ANALIZA MONETARE	2-14
2.1 OBJEKTIVAT E POLITIKES MONETARE	2-14
2.2 INSTRUMENTET MONETARE	2-16
2.2.1 Instrumentet Direkte	2-16
2.2.2 Instrumentet Indirekte	2-18
2.3 BAZA MONETARE DHE PARAJA GJITHSEJ	2-22
2.3.1 Baza Monetare	2-22
2.3.2 Paraja Gjithsej	2-22
2.4 KREDIA PER EKONOMINE	2-27
2.5 FINANCIMI I DEFICITIT BUXHETOR	2-29
2.5.1 Zhvillimet fiskale gjate vitit 1996	2-29
2.5.2 Financimi i deficitit buxhetor	2-30
3. BILANCI I PAGESAVE	3-32
3.1 ZHVILLIMET NE BILANCIN E PAGESAVE	3-32
3.2 ZHVILLIMET NE REZERVEN VALUTORE	3-40
3.3 TREGU DHE KEMBIMET VALUTORE	3-42
4. SISTEMI BANKAR DHE PERSOSJA E TIJ	4-44
4.1 PERSOSJA E BAZES LIGJORE	4-44
4.1.1 Ligji "Per Banken e Shqiperise"	4-44
4.1.2 Ligji "Per Sistemin Bankar"	4-45
4.2 MBIKËQYRJA BANKARE	4-46
4.3 PRIVATIZIMI I BANKAVE	4-49
4.3.1 Privatizimi i bankave tregtare me kapital shteteror	4-49
4.3.2 Licencimi i sistemit bankar	4-51
4.4 REFORMA NE SISTEMIN E KONTABILITETIT DHE TE PAGESAVE	4-53
5. REZULTATI FINANCIAR I VITIT 1996	5-54
6. AKTIVITETE TE TJERA	6-55
6.1 ADMINISTRIMI I PARASE	6-55
6.2 BURIMET NJEREZORE DHE KUALIFIKIMI I TYRE	6-57
6.2.1 Struktura Organizative dhe Organika	6-57
6.2.2 Gjendja e Personelit dhe Pagat	6-57
6.2.3 Asistenca Teknike dhe Kualifikimi	6-58
6.3 BURSA E TIRANES	6-60
6.3.1 Tregtimi ne Bursen e Tiranes	6-60
6.3.2 Anetaresimi dhe Listimi	6-60